



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Teknologji
Informacioni e Aplikuar në Financë”**

ofruar nga

Universiteti Europian i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Edra Fresku

Dr. Matilda Tola

Nëntor / 2025

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

website: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master Profesional në “Teknologji Informatikoni e Aplikuar në Financë” ofruar nga
Universiteti Europian i Tiranës

1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Teknologji Informatikoni e Aplikuar në Financë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS nr. 484, datë 30.08.2022.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	N/A
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike (katër semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.A. 2022-2023 - 5 PAE/4 PAK V.A. 2023-2024 - 7 PAE/4 PAK
18	Numri i studentëve:	V.A. 2022-2023 7 studentë V.A. 2023-2024 6 studentë V.A. 2024-2025 0 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Europian i Tiranës (UET) është një institucion arsimor privat, i pavarur dhe laik i Arsimit të Lartë në Shqipëri. i licencuar për herë të parë në vitin 2006 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, riorganizuar me VKM nr. 657, datë 28.09.2011 dhe akredituar me vendim BA nr. 82, datë 22.09.2023, me një vizion për të ofruar një arsim cilësor dhe inovativ për studentët shqiptarë. Me kalimin e viteve, UET është shndërruar në një nga institucionet më të rëndësishme të arsimit të lartë në Shqipëri, duke kontribuar në përgatitjen e një brezi të ri profesionistësh për të përmbushur kërkesat e tregut të punës vendas dhe ndërkombëtar.

Programi i studimit Master Profesional në “Teknologji Informacioni e aplikuar në Financë”, në gjuhën shqipe, 120 ECTS, me kohëzgjatje normale 2 vjeçare ofrohet nga UET sipas urdhërit nr. 484, datë 30.08.2022, lëshuar nga MAS. Programi akreditohet për herë të parë. Ky program ofrohet në bashkëpunim me institucionin financiar “Banka Credins Sh.A.”, e cila ushtron aktivitetin e saj në Shqipëri. Ky bashkëpunim konkretizohet me marrëveshjen e bashkëpunimit Nr. 58170, datë 26.11.2021 lidhur mes palëve me objekt krijimin e një programi studimi të ciklit të dytë Master Profesional me kohëzgjatje 2 vjeçare, 120 kredite.

Programi ofrohet nga “Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë”, njësi bazë e “Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës”, hapur sipas urdhërit nr. 529, datë 04.09.2018 nga MASR.

Programi ka si qëllim të pajisë studentët me njohuri teorike në teknologjitë digjitale dhe analizën e të dhënave si dhe zbatimin e tyre në praktikë në sektorin financiar. Ai ofron lëndë nëpërmjet të cilave studentët aftësohen në menaxhimin dhe përpunimin e të dhënave masive, sigurinë e të dhënave dhe sistemeve ose dizajnimin dhe zhvillimin e faqeve ëeb.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 109/2017, Autoriteti i Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) ka caktuar kohën dhe grupet për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Teknologji Informacioni e aplikuar në Financë” në Universitetin Europian të Tiranës. Procesi i vlerësimit është zhvilluar bazuar në Urdhrin nr. 29, datë 27.03.2025, me numër protokolli 14/5 të Autoritetit të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, për përcaktimin e ekspertëve për procesin e akreditimit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përbëhej nga **Dr. Edra Fresku dhe Dr. Matilda Tola**, me asistencën e Koordinatorit Teknik të ASCAL, Msc. Arbri Ndreka.

Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i përgatitur nga Universiteti Europian i Tiranës në Mars 2025, ka shërbyer si burimi kryesor i informacionit për GVJ-në, duke ofruar një analizë të detajuar mbi strukturat dhe mekanizmat e cilësisë të përdorura nga institucioni për menaxhimin dhe përmbushjen e objektivave akademike. Përveç raportit të brendshëm, universiteti ka ofruar një gamë të gjerë dokumentesh mbështetëse përmes sistemit të menaxhimit të cilësisë, të mundësuar nga ASCAL.

Procesi i vlerësimit është bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të nxjerra prej tij. Këto përfshijnë VKM-në nr. 531, datë 11.09.2018, për Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018, për elementët e programeve të studimit, si dhe ndryshimet përkatëse të bëra më vonë.

Takimet për vlerësimin u zhvilluan më 07.04.2025 dhe 08.04.2025, sipas një programi të miratuar nga ASCAL. Gjatë këtyre takimeve, GVJ-ja zhvilloi diskutime intensive me përfaqësues të Universitetit Europian të Tiranës, duke përfshirë Dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, Përgjegjësin e Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë, stafin akademik, studentët, si dhe përfaqësues nga njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe kurrikulave.

Gjatë procesit, grupi kreu edhe vizita në auditorë, laboratore dhe bibliotekë, për të shqyrtuar infrastrukturën dhe mbështetjen teknike të ofruar për programin. Analiza e programit u përqendrua në vlerësimin e strukturës së tij, përmbajtjes së syllabusit, objektivave të të mësuarit, kompetencave të synuara, metodave të mësimdhënies dhe materialeve mësimore. Gjithashtu, u shqyrtuan mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimi i krediteve akademike dhe kualifikimet e stafit akademik.

Në përfundim të vlerësimit, GVJ-ja përgatiti një raport që paraqet një analizë gjithëpërfshirëse të programit të studimit, duke përfshirë rekomandime për përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të tij. Ky raport synon të ndihmojë Universitetin Europian të Tiranës të forcojë pikat e forta dhe të adresojë sfidat e identifikuara në mënyrë që të përmbushë standardet më të larta të arsimit të lartë.

Më datë 03.11.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.14/36 Prot., datë 03.11.2025 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes sistemit AMS, më datë 10.11.2025 dhe me shkresë zyrtare Nr.161/11 Prot., datë 10.11.2025, ka dërguar komente mbi draft raportin:

GVJ, pasi u njoh me komentet e Universitetit European të Tiranës, për secilin prej standardeve, sqaron si më poshtë:

Standardi I.2, Kriteri 1: *GVJ rekomandon angazhimin e personelit akademik në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.*

Në analizën e tij UET konfirmon konstatimin e GVJ. GVJ vlerëson angazhimin dhe analizën e UET, megjithatë vlerëson se rekomandimi duhet të merret parasysh, prandaj **kriteri i vlerësuar nuk ndryshon.**

Standardi I.3, Kriteri 3 & Standardi III.4, Kriteri 4: *GVJ rekomandon që UET të shtojë angazhimin për pjesëmarrjen e studentëve në mobilitete në kuadër të projekteve ERASMUS +.*

GVJ vlerëson se struktura e programit të studimit MPTIAF dhe plani mësimor/kurrikula që ai ka ofrojnë mundësinë e realizimit të exchange/mobiliteteve të studentëve në programe të ngjashme në kuadër të projekteve ERASMUS+, prandaj **kriteri i vlerësuar nuk ndryshon.**

Standardi II.1, Kriteri 1: *GVJ rekomandon modifikimin e Planit mësimorë të ndarë sipas Veprimtarive Formuese (Evidencë 14.4 (Tabela 9) & web), ku lënda "Tregu bankar dhe institucionet e tij" duhet zëvendësuar me lëndën "Tregjet e kapitaleve dhe institucionet financiare".*

Bazuar në angazhimin e UET për të realizuar ndryshimin e rekomanduar nga GVJ, vlerësohet që **kriteri të ndryshohet duke hequr rekomandimin.**

Standardi II.3, Kriteri 4: *GVJ rekomandon të shtohet tipologjia e lëndës, të rakordohet mospërputhja e ngarkesës dhe/ose veprimtarive mësimore që reflektohen në syllabus-e me atë që është miratuar në planin mësimor, të azhurnohet masa e duhur e frekuentimit të detyrueshëm të procesit mësimor (75% ose 80%) dhe të reflektohet në syllabus ngarkesa e shprehur në kolonën "Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor".*

GVJ vlerëson hapat e ndërmarrë deri më tani nga ana e UET. Me qëllim përmbushjen e plotë të këtij rekomandimi, GVJ vendosë të **mos ndryshojë kriterin e vlerësuar.**

Standardi II.4, Kriteri 2: Konstatimi i GVJ lidhet me semestrin e IV-t në planin mësimor, ku reflektohet ngarkesë javore totale 40-42 orë/javë. UET duhet të angazhohet të reflektojë ngarkesën e Praktikës Profesionale në Planin Mësimor konform kornizës ligjore në fuqi referuar VKM nr. 41 të ndryshuar, prandaj **nuk ka ndryshime në kriterin e vlerësuar**.

Standardi II.6, Kriteri 3: GVJ rekomandon rritjen e mundësisë së pjesëmarrjes në konferenca periodike studentore me qëllim nxitjen për përfshirje dhe angazhim në studime dhe aktivitete kërkimore.

GVJ vlerëson angazhimin e UET për përfshirje të studentëve në vitin 2023-2024 në konferencën studentore DSSH Junior, megjithatë gjykon të ketë një rritje të masës së aktiviteteve të tilla, prandaj **kriteri i vlerësuar nuk ndryshon**.

Standardi IV.1, Kriteri 1: GVJ rekomandon që stafi me grada MSc të orientohet drejt gradave akademike në të ardhmen.

GVJ vlerëson angazhimin e UET për nxitjen dhe mbështetjen që ofron për stafin e saj akademik në kuadër të rritjes në tituj e grada dhe mbështetjes së vazhdueshme në kërkim shkencor. Ky rekomandim synon që stafi të plotësohet me grada dhe tituj duke i mbështetur në doktoratura e kërkim shkencor. Stafi Msc edhe pse është profesionalisht shumë i kualifikuar; në funksion të plotësimit të kërkesave ligjore për mësimdhënie në programin Master sugjerojmë orientimin drejt gradave shkencore prandaj **kriteri i vlerësuar nuk ndryshon**.

-UET të evidentojë personel ndihmës akademik për organizimin e mirëmbajtjes e laboratorëve për programin specifik të studimit.

GVJ vlerëson angazhimin e UET për krijimin e infrastruktures laboratorike dhe mirëmbajtjes së saj. Nga vlerësimi që u bë gjatë vizitës nuk ka vërejtje për përmbajtjen e kriterit. Qëllimi i këtij rekomandimi është të evidentojë në dokumentacionin e dorezuar dhe stafin specifik. Pra ky rekomandim ka si synim vetëm përmirësimin e paraqitjes së informacionit në raportim. Duke qënë se rekomandimi është i natyrës formale **kriteri i vlerësuar nuk ndryshon**.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga “Universiteti Europian i Tiranës” (UET), GVJ konstaton se në misionin e tij, IAL ka për qëllim të krijojë, transmetojë, zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor; të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj; të mbështesë zhvillimin kulturor e social-ekonomik në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Në planin strategjik UET është i angazhuar në edukim, kërkim shkencor, zhvillim stafi dhe jetë studentore, përmirësim cilësie në shërbime dhe infrastrukturë me qëllim kthimin e UET në një qendër ekspertize dhe ekselence me impakt rajonal. <i>Evidencë 2. Statuti UET_struktura organizative aktuale_shqip.pdf</i> <i>Evidencë 3. Plani Strategjik UET 2021-2025.pdf</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Master Profesional Master Profesional në “Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë” (MPTIAF) ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit. Në zbatim të misionit, objektivave dhe drejtimeve akademike të tij, UET ka për qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë, në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, si dhe të përgatisë specialistë që përmbushin kërkesat e tregut shqiptar dhe ndërkombëtar të punës. Gjithashtu ky program është hartuar në përputhje me Kornizën Shqiptare dhe atë Evropiane të Kualifikimeve, të bazuara në kërkim e inovacion si dhe të lidhura ngushtë me praktikën e aplikimin, për të përgatitur specialistë dhe ekspertë të mirëformuar. <i>Evidencë 2. Statuti UET_struktura organizative aktuale_shqip.pdf</i>

	<i>Evidencë 3. Plani Strategjik UET 2021-2025.pdf</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të Institucionit.	MP "TIAF" ofrohet në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. Objektivi kryesor i MP "TIAF" është të përgatisë specialistë me njohuritë e duhura për të zhvilluar sisteme më të sigurta kompjuterike dhe aplikimin e tyre në sektorin financiar. Gjithashtu synon t'i mundësojë studentëve një formim më të thelluar në këtë fushë dhe t'i përgatisë për tregun e punës në sektorin publik dhe atë privat. MP "TIAF" me 2 (dy) vite akademike është i organizuar si program i ciklit të dytë "Master Profesional", në respektim dhe zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/2015 dhe zhvillohet në përputhje me rregullat dhe parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë, Statutin e UET dhe aktet e brendshme rregullatore të tij. Ky program studimi është organizuar në 120 pikë kredite. <i>Evidencë 2. Statuti UET_struktura organizative aktuale_shqip.pdf</i> <i>Evidencë 3. Plani Strategjik UET 2021-2025.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi studimit MPTIAF zhvillohet në përputhje me: - Statutin e UET; - Planin Strategjik të UET 2021-2025; - Rregulloren e programit të studimit MP "TIAF"; - Agjendën Digjitale të Shqipërisë 2022-2026; <i>Evidencë 2. Statuti UET_struktura organizative aktuale_shqip.pdf</i> <i>Evidencë 3. Plani Strategjik UET 2021-2025.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 3.8. Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022-2026 dhe plani i veprimtimit.pdf</i>
Konkluzione	Bazuar në analizën e kritereve 1-4 të standardit I.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL, konstatohet se: - Programi i studimit MP "TIAF" i përgjigjet fushës së studimit të Universitetit Europian të Tiranës dhe Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë. - MP "TIAF" është i hartuar në përshtatje dhe në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor dhe

Statutit të Universitetit European të Tiranës.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve									
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UET është një institucion jopublik i arsimit të lartë i cili ka nisur ushtrimin e aktivitetit të tij me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 636, datë 20.09.2006. Njësitë kryesore të UET janë: - Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale - Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit - Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike - Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës (FIIA) - Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare FIIA ka në përbërje të tij: • Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë (DIT) • Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës • Qendra për Zhvillimin e Teknologjisë dhe Inovacionin DIT është përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në “Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë” (MPTIAF). Angazhimi i stafit akademik në MPTIAF sipas dy viteve të fundit akademike është si më poshtë vijon: <table><tr><th>Viti akademik</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>2022-2023</td><td>5 1-Prof.Dr. 3-Dr. 1-Msc.</td><td>4 1-Dr.proc. 3-Msc.</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>7 1-Prof.Dr. 5-Dr. 1-Msc.</td><td>4 1-Dr. 1-Dr.proc. 2-Msc.</td></tr></table>	Viti akademik	PAE	PAK	2022-2023	5 1-Prof.Dr. 3-Dr. 1-Msc.	4 1-Dr.proc. 3-Msc.	2023-2024	7 1-Prof.Dr. 5-Dr. 1-Msc.	4 1-Dr. 1-Dr.proc. 2-Msc.
Viti akademik	PAE	PAK								
2022-2023	5 1-Prof.Dr. 3-Dr. 1-Msc.	4 1-Dr.proc. 3-Msc.								
2023-2024	7 1-Prof.Dr. 5-Dr. 1-Msc.	4 1-Dr. 1-Dr.proc. 2-Msc.								
	Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë nr.80, 2015, Neni 59, pika 6 thuhet									

	se: - Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Në vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-2024 vërehet përkatësisht <u>angazhimi i 1 (një) staf akademik Doktor në proces dhe 4 (katër) staf akademik me Msc., si dhe 1 (një) staf akademik Doktor në proces dhe 3 (tre) staf akademik me Msc. GVJ rekomandon angazhimin e personelit akademik në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</u> Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL në lidhje me formimin e personelit akademik të DIT, CV-të, GVJ vlerëson se plotësohen kapacitetet akademike për ofrimin e këtij programi studimi. <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela 1, 2).pdf</i> <i>Evidencë 20. CV (Stafi MPTIAF).pdf</i> <i>Evidencë shtesë 9. CV (Stafi DIT).pdf</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Evidencaeruar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga GVB, që i Evidencaerohet Statutit të UET dhe rregulloreve në tërësi rezulton se fusha e përgjithshme dhe specifike e MPTIAF është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore FIJA, përgjegjëse për këtë program e studimi. Gjithashtu përputhshmëria konstatohet edhe në disa nga programet që ofrohen nga kjo njësi kryesore të cilat janë: - Bachelor në “Teknologji Informacioni” me profil: “Hartim Softëare”; “Grafik-Dizajn” - Master Profesional “Informatikë e Aplikuar” me profil: “Dizenjim dhe zhvillim aplikimesh”; “Menaxhim të dhënash”; “Siguria e sistemeve të informacionit”; “Menaxhim dhe vlerësim projektsh” - Master shkencor “Teknologji Informacioni” me profil: “IT e biznesit” ; “Zhvillim Softëare-sh” ; “Menaxhim dhe Vlerësim projektsh” ; “Inovacion” Programi i studimit MPTIAF është kodifikuar me kodin: 72MP0688S, bazuar edhe në klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane (VKM. 310, datë 11.05.2022). <i>Evidencë 2. Statuti UET_struktura organizative aktuale_shqip.pdf</i> <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 31.1. VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 “Për specifikimet dhe</i>

	<i>përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit...".pdf</i> <i>Evidencë 31.4. Njoftim i MAS mbi procesin e kodifikimit të programeve të studimit.pdf</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitet bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Evidencaeruar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga GVB, që i Evidencaerohet Statutit të UET dhe rregulloreve në tërësi konstatohet se DIT është njësi bazë e FIJA që e ofron këtë program studimi dhe e zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të standardeve të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Programi MPTIAF (120 ECTS) me dy vite akademike është konceptuar në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë që është përgjegjëse për këtë program studimi. <i>Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë dhe në përputhje me kërkesat e VKM-së nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve ...", i ndryshuar.</i> <i>Evidencë 2. Statuti UET_struktura organizative aktuale_shqip.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	DIT / FIJA / UET nuk ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit. Megjithatë për të plotësuar maksimalisht objektivat formuese IAL ka nënshkruar një bashkëpunim me Bankën Credins për të arritur qëllimin e këtij programi studimi. <i>Evidencë 2. Statuti UET_struktura organizative aktuale_shqip.pdf</i> <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 34.1. Marreveshje bashkepunimi UET dhe Credins në funksion të programit.pdf</i>
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga GVB si dhe nga vizita në institucion rezulton se DIT në kuadër të marrëveshjes me Bankën Credins realizon praktika lëndore dhe profesionale specifike për nevojat e këtij programi studimi. Megjithatë, UET në kuadër të ruajtjes së kontakteve dhe shkëmbimit të eksperiencave me studentët ALUMNI, realizon në mënyrë të vazhdueshme leksione të hapura në interes edhe të programit të studimit. <i>Evidencë 34.1. Marreveshje bashkepunimi UET dhe Credins në funksion të programit.pdf</i> <i>Evidencë 14.2 Plani mësimor i programit Teknologji Informacioni e</i>

	<i>Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 33. Të dhëna për trajnime profesionale.pdf</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-4 të standardit I.2, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> - <i>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</i> - <i>Njësia bazë ka peshën kryesore për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</i> - <i>GVJ vlerëson se DIT zotëron kapacitetet e duhura akademike për ofrimin e këtij programi studimi.</i> - <i>Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se UET siguron bashkëpunimin dhe realizon ndarjen e detyrave mes njësive e personelit në rregulloret respektive, si dhe ndjekjen e zbatimit të tyre. Nga vlerësimi rezulton se DIT menaxhon dhe drejton me efektivitet programin e ciklit të dytë MP "TIAF", i cili ka një kohëzgjatje 2-vjeçare dhe në total përmban 120 kredite. GVJ konstatoi që ndarja e detyrave, vendimmarrja dhe llogaridhënia janë të harmonizuara në aktet rregullatore të institucionit. Njësia bazë ka peshën kryesore për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Përcaktimi i koordinators të programit të studimit është një element i rëndësishëm që lidhet ngushtësisht me këtë peshë. GVJ konstaton se institucioni e mbikëqyr mbarëvajtjen e programit të studimit me analiza të vazhdueshme të punës së bërë brenda

	fakultetit duke nxitur dhe mbështetur një marrëdhënie eficiente bashkëpunimi midis gjithë aktorëve në vazhdimësi. <i>Evidencë 2. Statuti UET_struktura organizative aktuale_shqip.pdf</i> <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 36.1. Vendim dekanati për koordinatorët e programeve.pdf</i> <i>Evidencë 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit.pdf</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se UET ka marrëveshje bashkëpunimi të shumta me IAL vendase dhe të huaja si dhe biznese për realizimin e objektivave formuese dhe procesit mësimor. Vlen të përmendim: - Banka Credins - Smart Tech Solutions - Lufthansa Industry Solutions - Union Bank - INSTAT - Balfin etj. <i>Evidencë 34.1. Marrëveshje bashkëpunimi UET dhe Credins në funksion të programit.pdf</i> <i>Evidencë 34. Marrëveshje bashkëpunimi - lista UET.pdf</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe	GVJ evidentoi se UET/FIIA/DIT kanë realizuar një bashkëpunim të frytshëm me Bankën Credins në kuadër të realizimit të një kurrikule specifike siç është ajo e programit të studimit MP "TIAF". Institucioni bankar ofron stafin, ambientet dhe teknologjitë e nevojshme për realizimin sa më konkret të procesit mësimorë/praktik me qëllim plotësimin e objektivave formues të programit të studimit. Në të njëjtën kohë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi më IAL në vend dhe jashtë, si dhe në kuadër të projekteve ERASMUS +, exchange dhe mobilitet. <i>Aktualisht nuk ka projekte ERASMUS +, exchange dhe mobilitete aktive në këtë program studimi(studentë).</i> <i>GVJ rekomandon që UET të shtojë angazhimin dhe aplikimet për këto projekte pasi mbështesin përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe në mësimnxënie në programin e studimit, si dhe realizimin e programit të studimit.</i>

mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	<i>Evidencë 34.1. Marrëveshje bashkëpunimi UET dhe Credins në funksion të programit.pdf</i> <i>Evidencë 43.3. Marrëveshjet aktive për mobilitetin e personelit akademik.pdf</i> <i>Evidencë 43.1. Raporti i mobiliteteve_staf_studentë.pdf</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Nga UET, FIJA dhe DIT, si pjesë e analizës vjetore të vetëvlerësimit realizohet dhe paraqitet një analizë e bashkëpunimit me aktorët e jashtëm dhe përfitimit në kuadër të procesit mësimor dhe formues. <i>Evidencë 35. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit - Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë.pdf</i> <i>Evidencë 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit.pdf</i>			
Konkluzione	Bazuar në analizën e kriterëve 1-4 të standardit I.3, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se: - UET ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione publike dhe kompani private në vend dhe jashtë në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional dhe mobilitetit, në mënyrë të veçantë me Bankën Credins. - UET ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi me IAL në vend dhe jashtë, si dhe në kuadër të projekteve ERASMUS +, exchange dhe mobilitet. Aktualisht nuk ka projekte ERASMUS +, exchange dhe mobilitete aktive në këtë program studimi. - <u>GVJ rekomandon që UET të shtojë angazhimin dhe aplikimet për këto projekte pasi mbështesin përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe në mësimnxënie në programin e studimit, si dhe realizimin e programit të studimit.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	GVJ konstaton se struktura e programit të studimit MP "TIAF" është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje prej 2 vitesh akademike të shpërndarë në 4 semestra (në total 120 kredite) dhe përmban të shprehura shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, një ndarje të qartë sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të ndryshuar. GVJ konstaton se përqindjet sipas secilit tip të komponentëve mësimor janë në përputhje me VKM nr. 41: • Lëndët bazë: 10%; • Lëndët karakterizuese: 40%; • Lëndët ndërdisiplinore: 20%; • Lëndët plotësuese: 10%; • Detyrimet përmbyllëse: 20%. <i>Evidencë 14. Kurrikula e programit Teknologji Informacioni e aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 14.4. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - Master Profesional Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Tabela 9).pdf</i> <i>Evidencë 19. Formati i Syllabusit shqip_anglisht_vkm 41_2018.pdf</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik	Qëllimi i programit MP "TIAF" me 120 kredite është të përgatisë specialistë të aftë për menaxhimin e teknologjisë së informacionit në përgjithësi dhe proceset e zhvillimit të sistemeve të informacionit në veçanti, të specializuar për sektorin financiar. Ky program studimi ndër të tjera ka për qëllim të formojë gjeneratën e re të profesionistëve, të cilët do të kenë njohuritë e duhura dhe eksperiencat për të zhvilluar dhe mirëmbajtur programe softuerike dhe aplikacione duke kuptuar

të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	kërkesat e biznesit. Ai synon t'i pajisë studentët me njohuritë dhe bazat teorike, si dhe me aftësitë dhe praktikat e nevojshme në fushën e analizimit dhe administrimit të të dhënave masive duke përdorur mjetet e duhura për përpunimin e tyre dhe të kuptojë kërkesat e sektorit financiar. <i>GVJ konstaton se ky objektivi përmbushet dhe rezulton e shprehur qartë në rregulloren e programit dhe në syllabuset e lëndëve.</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 19.1-19.16</i> <i>4. Evidencë shtesë për syllabuset Data Mining.pdf</i> <i>4. Evidencë shtesë për syllabuset Seancat metodologjike.pdf</i> <i>4. Evidencë shtesë për syllabuset Praktikë Profesionale.pdf</i> <i>4. Evidencë shtesë për syllabuset Zhvillime ëbe aplikime dhe programim.pdf</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, vizita në institucion dhe dokumentacioni shtesë i kërkuar, GVJ konstaton se programi i studimit MP "TIAF" në kurrikulën e tij parashikon zhvillimin e Praktikë/Internship si veprimtari formuese dhe ka përcaktuar ngarkesën me 12 kredite, me: - 240 orë gjithsej, të cilat do të zhvillohen në auditor dhe pranë Bankës Credins (RVB) - 240 orë praktikë profesionale, praktikë në terren apo stazh dhe 60 orë në punë individuale e studentit (14.2 Plani mësimor i programit Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf) - 240 orë në një institucion/organizatë/kompani dhe 60 orë janë punë individuale e studentit (takime me pedagogun, përgatitja e raportit përfundimtar etj). (32.1.Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale.pdf) - 8 orë në auditor, 240 orë në një institucion / organizatë/kompani (4. Evidencë shtesë për syllabuset Praktikë Profesionale.pdf) - 8 orë në auditor (4 seanca nga 2 orë), 267 orë praktikë pranë institucionit financiar dhe 25 orë janë punë individuale e studentit (takime me pedagogun, përgatitja e raportit përfundimtar etj) (38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit.pdf)

	<u>GVJ rekomandon unifikim të dokumentacionit lidhur me ngarkesën auditor/Baka Credins/orë individuale për lëndën Praktikë/internship.</u> GVJ konstaton se syllabus-i i lëndës “Praktikë/internship” parashikon tema vetëm për 4 seancat e zhvilluara në auditor. <u>GVJ rekomandon që departamenti në marrëveshje me personelin mbikqyrës të studentëve praktikantë pranë Bankës Credins, të hartojë në mënyrë të detajuar temat që duhet të trajtohen gjatë zhvillimit të praktikës në institucion. (në zbatim të pikës 7.4 në Rregulloren e MP “TIAF”)</u> GVJ konstaton se nuk ka asnjë dokument ku tregon se në cilat javë të semestrit të IV-ët zhvillohet lënda Praktikë/Internship (auditor/institucion). <u>GVJ rekomandon specifikim të javëve kur studenti do të zhvillojë praktikën profesionale në auditor dhe në Bankën Credins.</u> Gjithashtu, në lidhje me masën e frekuentimit për Praktikë/internship, GVJ konstaton se: - Orët e praktikave profesionale janë të detyrueshme. Ato duhen frekuentuar në masën 75%. (32.1.Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale.pdf, pika B.I.4.5 dhe rregulloren e UET, pika 25.2) - Prezenca në veprimtari mësimore (leksione / seminare / laboratore / praktika) është e detyrueshme në masën 80% (4.Evidencë shtesë për syllabuset Praktikë Profesionale.pdf) - Orët e praktikës profesionale janë të detyrueshme për t’u frekuentuar nga studentët në masën 60%. (38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit.pdf) <u>GVJ rekomandon unifikim të dokumentacionit lidhur me masën e frekuentimit për lëndën Praktikë/internship.</u> Në lidhje me Kontrollin e vazhdueshëm GVJ konstaton se: në syllabus reflektohet: - Seancat në auditor 10% të notës - CV, letër interesi dhe intervistë me shkrim 10% të notës - Mbrojtje dhe dokumentacion 80% të notës në dokumentin B.I - Mbi praktikën profesionale, pika B.I.8.1. Elementet përbërës të vlerësimit janë: a. Shfuqizuar. b. Vlerësimi i CV-së, i letrës së interesit dhe i intervistës me shkrim, 10% të notës;
--	---

- c. Mbrojtja e praktikës profesionale së bashku me dokumentacionin përkatës **90%** të notës, ose **100%** e saj në rastin e programeve të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave / Master i Arteve dhe Master Profesional.

GVJ rekomandon unifikim të dokumentacionit lidhur me Kontrollin e vazhdueshëm për lëndën Praktikë/internship.

Gjithashtu, duke qenë se Praktikë/internship është një lëndë e detyrueshme, GVJ sugjeron që UET të pasqyrojë informacion të hollësishëm të secilit prej stafit udhëheqës të kësaj lënde në institucionin e Bankës Credins, duke qenë se ato luajnë një rol të rëndësishëm edhe në plotësimin e dokumentacionit përfundimtar të praktikës profesionale. (formulari B.I.3)

Në përmbledhje të analizës se mësipërme GVJ rekomandon hartimin e një paketë të detajuar të Praktikës profesionale specifikisht për programin e studimit MP "TIAF", bazuar në dokumentet e përgjithshme Evidencaeruese institucionale dhe në përmbushje të të gjitha mangësive dhe parregullsive të lartpërmendura.

Gjithashtu për Punimin e Diplomës ka përcaktuar ngarkesën me 24 kredite, që në përgjithësi është Punim Diplome, bazuar në kriteret e miratuara në rregulloren e programit të studimit (neni 8), ku mungon kufiri i notës mesatare që studenti duhet të plotësojë, dhe në raste të veçanta Provim i Përgjithshëm Përfundimtar (PPP), ku studenti pajiset me programin përkatës/fondin e pyetjeve. Në dokumentin për punimin e diplomës dhe disertacionit, pika B.II.2.4.b. thuhet se: "Studentët që kanë në hyrje notën mesatare 7.5 mund të aplikojnë për punim diplome", gjë që u konfirmua edhe nga takimi me studentët.

GVJ rekomandon përcaktimin e pragut të notës mesatare për të mbrojtur një punim diplome edhe në rregulloren e programit të studimit MP "TIAF". Sa i përket frekuentimit të seancave metodologjike, në pikën B.II.5.1.d. thuhet se: "Frekuentimi i seancave metodologjike është i detyrueshëm në masën 60%", ndërsa në syllabusin e lëndës masa e frekuentimit është 80%.

GVJ rekomandon unifikim të dokumentacionit lidhur me masën e frekuentimit të Seancave Metodologjike.

	<i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 14.2 Plani mësimor i programit Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 32.1.Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale.pdf</i> <i>4. Evidencë shtesë për syllabuset Praktikë Profesionale.pdf</i> <i>38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit.pdf</i> <i>5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf</i> <i>Evidencë 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin (Tabela 21).pdf</i> <i>Evidencë shtesë 5. PPP MP Fintech 2023-24.pdf</i> <i>4. Evidencë shtesë për syllabuset Seancat metodologjike.pdf</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Ky kriter nuk aplikohet në këtë program studimi.
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të	Ky kriter nuk aplikohet në këtë program studimi.

kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar konstatohet se UET nuk është me status të veçantë, në kuptim të nenit 84 të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën Shqipërisë”. Për këtë shkak, kriteri 6 nuk merret në analizë prej GVJ.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit MPTIAF ka për fushë studimi atë të teknologjisë së informacionit të aplikuar në financë. <i>GVJ bazuar në dokumentacionin bashkangjitur RVB (evidencat) si dhe dokumentacionin shtesë të kërkuar gjatë vizitës në institucion, vlerëson se UET përmbush kriterin e ngjashmërisë së përmbajtjes me programe të tjera të fushës në masën së paku 70 %.</i> Përmendim këtu universitete brenda vendit si UT (Master Shkencor në Sisteme Informacioni në Ekonomi), por edhe të huaja si University of Central Florida (Master of Science in Fintech) <i>1. Evidencë shtesë për ngjashmëri 70% me programe vendase ose të huaja .pdf</i> <i>Evidencë 17. Studimi për tregun e punës.pdf</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit MP “TIAF” është kodifikuar me kodin: 72MP0688S, bazuar edhe në klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane (VKM. 310, datë 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”). <i>Evidencë 31.3. Shkresë UET_propozimet për kodifikimin e programeve të studimit.pdf</i> <i>Evidencë 31.1. VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit...” .pdf</i>
Kriteri 9. Programet e	Ky kriter nuk aplikohet në këtë program studimi.

studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-9 të standardit II.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> - <i>GVJ konstaton se ky program studimi synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh dhe rezulton e shprehur qartë në rregulloren e programit dhe në syllabuset e lëndëve.</i> - <i>Programi i studimit MPTIAF është kodifikuar bazuar në klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</i> - <i>GVJ vlerëson se UET përmbush kriterin e ngjashmërisë së përmbajtjes me programe të tjera të fushës në masën së paku 70 %.</i> - <i><u>GVJ rekomandon</u> hartimin e një paketë të detajuar të Praktikës profesionale specifiku për programin e studimit MPTIAF, bazuar në dokumentet e përgjithshme Evidencaeruese institucionale dhe në përmbushje të të gjitha mangësive dhe parregullsive të evidentuara në Standardin II.1, Kriteri 3.</i> - <i><u>GVJ rekomandon</u> përcaktimin e pragut të notës mesatare për të mbrojtur një punim diplome edhe në rregulloren e programit të studimit MPTIAF dhe unifikim të dokumentacionit lidhur me masën e frekuentimit të Seancave Metodologjike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, nga

kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

evidencat përkatëse që e shoqërojnë, por dhe nga takimet me dekanin, me përgjegjësin e departamentit dhe me stafin që mbulon programin, rezulton se DIT është njësi bazë e FIILA. Ai e zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të standardeve të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. FIILA ka në përbërje të tij:

- Departamentin e Informatikës dhe Teknologjisë (DIT)
- Departamentin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës
- Qendrën për Zhvillimin e Teknologjisë dhe Inovacionit

Evidencaeruar të dhënave tabelore për personelin akademik rezulton se FIILA si njësi kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2023-2024 ka gjithsej 90 pedagogë, nga të cilët 40 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 51 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës		Raporti
	PAE	PAK	PAE / PAK
Prof. Dr.	4	2	4 / 2
Prof. as. Dr.	4	3	4 / 3
Dr/PhD	12	13	12 / 12
Dr. proc.	9	3	9 / 3
Msc.	11	30	11 / 30
Total	40	51	40 / 51

Organizimi i njësive kryesore/bazë bëhet në Evidencaerencë të Vendimit të MASR nr.418, datë 10.5.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre", sipas të cilit kërkesë kryesore për hapjen e një programi studimi është që *njësia bazë duhet të ketë në përbërje të tij, të paktën, 7 anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik.*

Njësia bazë që ofron programin e studimit MPTIAF përbëhet aktualisht nga 21 anëtarë të personelit akademik efektiv (PAE), nga të cilët (1) me titull Prof. Dr, (1) me titull Prof. As. Dr., (6) Dr., (7) Dr. proc. si edhe (6) me Msc. Gjithashtu në departament janë të përfshirë edhe 32 antare të personelit akademik me kontratë (PAK). Tabela më poshtë pasqyron personelin akademik të njësisë bazë (DIT) për vitet akademike 2021-2022, 2022-2023 dhe 2023-2024.

Tituj/ grada	2021-2022	2022-2023	2023-2024
--------------	-----------	-----------	-----------

	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	1	1	-	1	-
Prof. as. Dr.	-	1	1	2	1	3
Dr./PhD.	4	6	7	6	6	7
Dr. proc.	-	-	1	1	7	3
Msc.	6	6	8	16	6	19
Total	11	14	18	25	21	32

Nga verifikimi i personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie, GVJ konstaton një nivel të kënaqshëm qëndrueshmërie në personelin akademik të anagazhuar në MPTIAF.

Raporti PAE/PAK sipas viteve akademike e personelit të anagazhuar në MPTIAF është si mëposhtë:

Viti Akademik	Raporti PAE / PAK
2022-2023	5 / 4
2023-2024	7 / 4

Raporti PAE/PAK në lidhje me ngarkesën mësimore, për vitet 2022-2023 dhe 2023-2024, është i ndikueshëm nga përzgjedhja që bëjnë studentët për grup-lëndët e kategorisë C në vitin e parë, duke qenë se 2 prej tyre realizohen nga personel akademik PAE dhe 2 nga personel akademik PAK. Skenarët e mundshëm janë si mëposhtë vijon:

1. Në rastin kur një student zgjedh 2 lëndë të realizuara nga personel PAE, atëherë raporti PAE/PAK është respektivisht sipas viteve **81% / 19% dhe 82% / 18%.**
2. Në rastin kur një student zgjedh 2 lëndë të realizuara nga personel PAK, atëherë raporti PAE/PAK është respektivisht sipas viteve **59% / 41% dhe 68% / 32%.**
3. Në rastin kur studenti zgjedh 1 lëndë të realizuar nga PAE dhe 1 lëndë të realizuar nga PAK, atëherë raporti PAE/PAK është respektivisht sipas viteve **70% / 30% dhe 75% / 25%.**

Pra, në skenarin e parë dhe të tretë departamenti është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi (*Vendim Nr. 418, date 10.05.2017*), ndërsa në skenarin e dytë ngarkesa mësimore nuk mbulohet në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. GVJ sugjeron që IAL të ruajë në vazhdim raportin PAE/PAK, bazuar në kornizën ligjore në fuqi, për të gjithë studentët që janë pjesë e këtij programi studimi duke i

kushtuar kryesisht vëmendje shpërndarjes së ngarkesës së grup-lëndëve me zgjedhje.

GVJ konstaton se në grupin e lëndëve me zgjedhje: “Data mining”, “Inteligjenca artificiale” dhe “Aplikimi i sistemeve të informacionit”, lënda “Aplikimi i sistemeve të informacionit” ka ngarkesë 60 orë në auditor, ndryshe nga lëndët e tjera me zgjedhje të këtij grupi që kanë ngarkesë 64 orë në auditor. GVJ rekomandon që lëndët që bëjnë pjesë në një grup-lëndësh me zgjedhje të kenë të njëjtën ngarkesë mësimore në auditor.

GVJ, bazuar në planin mësimorë, në kolonat e detajuara të tij “Mësim në auditor dhe terren”, konstaton se IAL për lëndën “Praktikë/internship”:

- ngarkesën prej 240 orësh e klasifikon si “Praktika profesionale / praktika në terren / stazh”,
- nuk reflekton fare ngarkesën prej 8 orësh në auditor dhe
- ka ngarkesë javore 40 orë / javë.

Ndërsa në kolonën “Gjithsej” konstaton se IAL:

- ngarkesën prej 240 orësh e klasifikon si orë në auditor dhe
- ngarkesën prej 60 orësh e klasifikon si “Studim individual”.

GVJ, bazuar në planin mësimorë dhe në syllabuset e lëndëve “Menaxhimi i proceseve të biznesit”, “Projektim dhe analizë e bazave të të dhënave”, “Sisteme të vendimmarrjes bazuar në excel”, “Menaxhimi i rrjetave kompjuterike”, “Arkitektura dhe inxhinierimi i sistemeve”, konstaton se në secilën prej lëndëve zhvillohen 30 orë praktike në bankë (dmth orë jashtë auditori), të cilat në planin mësimorë klasifikohen në kolonën “Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe senaca të Praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor” dhe në fund llogariten në totalin e orëve në auditor.

Në Relacion, UET thekson se:

- 240 orët e praktikës profesionale janë orë jashtë auditori dhe si rrjedhojë ato përjashtohen nga dispozita e pikës 2.1, shkronja d, Vendim Nr. 41, datë 24.1.2018, ku thuhet se:
 - o “Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është deri në 30 (tridhjetë) orë mësimore 50-minutëshe”

duke nënkuptuar që ngarkesa 40 orë / javë për lëndën

“Praktikë/internship”, që UET reflekton në planin mësimor, **është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.**

Evidencaeruar Vendim Nr. 41, datë 24.1.2018 dhe ndryshimeve të tij ndër vite, GVJ konstaton se UET, në Relacion, citon dispozitën e pikës 2.1, shkronja d, të Vendim 823 datë 28.12.2023 për Disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ndryshuar, gjë e cila bie ndesh me periudhën për të cilën zhvillohet procesi i akreditimit të programit të studimit. Megjithatë, në të dy rastet (VKM e 2018 dhe VKM 2023), GVJ konstaton se ngarkesa javore e lëndës “Praktikë/internship” nuk plotëson dispozitën e pikës 2.1, shkronja d.

GVJ bazuar në:

- Vendim Nr. 41, datë 24.1.2018, 2.1, pika c, ku thuhet se: Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh në arsimin e lartë, nga një student me kohë të plotë, është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ose 1 500 (një mijë e pesëqind) orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë **orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij.**
- Vendim Nr. 41, datë 24.1.2018, 2.1, pika d, ku thuhet se: “Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është deri në **25 (njëzet e pesë)** orë mësimore 50-minutëshe”
- Tabelat përmbledhëse të ASCAL, Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10, ku totali i orëve që zhvillohen në auditor dhe terren klasifikohet në dy forma: **auditor dhe studim individual i studentit.**
- Faktin se Praktika profesionale është e klasifikuar në kurrikul si lëndë plotësuese (kategoria D), është lëndë e detyrueshme, ka frekuentim të detyrueshëm që duhet shlyer nga studenti, si dhe mbikëqyret nga udhëheqës i/të caktuar nga IAL dhe udhëheqës i/të caktuar nga Banka Credins,

vlërdëson se:

të gjitha veprimtaritë mësimore të detyrueshme për studentin, që zhvillohen brenda apo jashtë auditorit, dhe që mbikëqyren nga IAL apo institucionet bashkëpunuese, duhet të klasifikohen si orë në auditor

	dhe <u>rekomandon</u> që lënda “Praktikë/internship” nuk duhet të përjashtohet nga asnjë prej pikave të kornizës ligjore në fuqi dhe: - të respektohet ngarkesa maksimale javore në raportin orë auditor/studim individual/orë në javë, bazuar në VKM Nr. 41, të ndryshuar. - syllabusi të përfshijë të gjitha temat që parashikohen të zhvillohen në institucionin e praktikës, Bankën Credins. - të shpërndahet/reflektohet e gjithë ngarkesa mësimore që zhvillohet në institucionin e praktikës, nga udhëheqësi/t i/e caktuar nga Banka Credins. GVJ konstaton se “Punimi i diplomës” pasqyrohet në planin mësimorë 36 orë seminare në auditor (10 orë në semestrin e parë dhe 26 orë në semestrin e dytë) dhe 564 orë punë e pavarur (140 orë në semestrin e parë dhe 424 orë në semestrin e dytë) dhe ngarkesa në auditor për semestrin e dytë (26 orë në auditor) nuk mbulohet nga personel akademik dhe nuk reflektohet në orarin mësimorë. <u>GVJ rekomandon</u> që UET/DIT ta shpërndajë të gjithë ngarkesën në auditor, ose ta kalojë ngarkesën e pashpërndarë si punë e pavarur e studentit si dhe ta reflektojë në orarin mësimorë. <i>Evidencë 2. Statuti UET_struktura organizative aktuale_shqip.pdf</i> <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela 1, 2).pdf</i> <i>Evidencë 24. Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin studimit ndër vite (Aneks Tabela 6, 7, 8, 12).pdf</i> <i>2. Evidencë shtesë për përzgjedhjen e lëndëve me zgjedhje që kanë bërë studentët për vitet 2023-2024.pdf</i> <i>7. Evidencë shtesë e shpërndarjes së ngarkesës mësimore të personelit akademik në MPTIAF për vitin 2023-2024.pdf</i> <i>8. Evidencë shtesë për stafin e FIJA për vitet 2022-2023 dhe 2023-2024.pdf</i> <i>Evidencë shtesë - Relacion mbi plotësimin e dokumentacionit.pdf</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, në plotësim të detyrimeve të përcaktuara ligjore, ka të angazhuar personel ndihmës akademik/administrativ në mbështetje të realizimit të procesit mësimorë (Tabela 8). Megjithatë Evidencaeruar evidencës

legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	23 (Tabela 1.1, 1.2, 1.3) dhe evidencës shtesë 8 (Tabela 1), GVJ konstaton mungesën e personelit ndihmës akademik atashuar FIIA apo DIT. <u>GVJ sugjeron që UET të angazhojë personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. pranë FIIA/DIT, në përputhje me specifikat e fakultetit/departamentit dhe vetë programit të studimit.</u> <i>Evidencë 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela 1, 2).pdf</i> <i>8. Evidencë shtesë për stafin e FIIA për vitet 2022-2023 dhe 2023-2024.pdf</i> <i>Evidencë 24. Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin studimit ndër vite (Aneks Tabela 6, 7, 8, 12).pdf</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në IAL, GVJ konstaton se njësia bazë (DIT), përgjegjëse për programin e studimit MPTIAF, ka caktuar koordinatorin e programit të studimit. Koordinatori i MPTIAF ndjek dhe merr masat e nevojshme në funksion të mbarëvajtjes së programit të studimit. Mbështetur në vendimin Nr. 566/1, datë 11.11.2024 është emëruar në detyrën e Koordinatorit të DIT, Dr. A. K. <i>Evidencë 36.1. Vendim dekanati për koordinatorët e programeve.pdf</i>
Konkluzione	Bazuar në analizën e kriterëve 1-3 të standardit II.2, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se: - GVJ konstaton se organizimi i njësive kryesore/bazë bëhet në Evidencaerencë të Vendimit të MASR nr.418, datë 10.5.2017 - GVJ konstaton një nivel të kënaqshëm qëndrueshmërie në personelin akademik të anagazhuar në MPTIAF. - GVJ sugjeron që IAL të ruajë në vazhdim raportin PAE/PAK, bazuar në kornizën ligjore në fuqi, për të gjithë studentët që janë pjesë e këtij programi studimi duke i kushtuar kryesisht vëmendje shpërndarjes së ngarkesës së grup-lëndëve me zgjedhje. - <u>GVJ rekomandon që lëndët që bëjnë pjesë në një grup-lëndësh me zgjedhje të kenë të njëjtën ngarkesë mësimore në auditor.</u>

	- <u>GVJ rekomandon që lënda "Praktikë/internship" nuk duhet të përjashtohet nga asnjë prej pikave të kornizës ligjore në fuqi dhe:</u> - o të respektohet ngarkesa maksimale javore në raportin orë auditor/studim individual/orë në javë, bazuar në VKM Nr. 41, të ndryshuar. - o syllabusi të përfshijë të gjitha temat që parashikohen të zhvillohen në institucionin e praktikës, Bankën Credins. - o të shpërndahet/reflektohet e gjithë ngarkesa mësimore që zhvillohet në institucionin e praktikës, nga udhëheqësi/t i/e caktuar nga Banka Credins. - <u>GVJ rekomandon që UET/DIT ta shpërndajë dhe ta reflektojë në orarin mësimorë të gjithë ngarkesën në auditor për Punim Diplome, ose ta kalojë ngarkesën e pashpërndarë si punë e pavarur e studentit.</u> - <u>GVJ sugjeron që UET të angazhojë personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. pranë FIJA/DIT, në përputhje me specifikat e fakultetit/departamentit dhe vetë programit të studimit.</u> - <u>GVJ konstaton se njësia bazë (DIT), përgjegjëse për programin e studimit MPTIAF, ka caktuar koordinatorin e programit të studimit.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ konstaton se DIT, si njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit MPTIAF, disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ky informacion publikohet dhe në faqen kryesore të UET (https://uet.edu.al/). DIT, disponon informacionet dhe ka vënë në dispozicion dokumentacionin për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: rregulloren e programit të studimit, planin mësimor, syllabuset

	e lëndëve, stafin akademik të programit etj. <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 14. Kurrikula e programit Teknologji Informacioni e aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidenca 19.1-19.6 syllabuse</i> <i>4. Evidencë shtesë për syllabuset</i> https://uet.edu.al/ep-content/uploads/2024/01/MP-Teknologji-Informacioni-e-Aplikuar-ne-Finance.pdf
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Nga shqyrtimi i rregullores së programit, planit mësimor dhe syllabuseve të programit të studimit, GVJ konstaton se ky program studimi përmban 14 lëndë semestrale (nga këto 4 lëndë me zgjedhje), Praktikë/internship dhe Punimi i diplomës. Në semestrin e parë zhvillohen 10 lëndë semestrale (nga këto 2 lëndë me zgjedhje), ndërsa në semestrin e dytë 4 lëndë semestrale (nga këto 2 lëndë me zgjedhje), Praktikë/internship dhe Punimi i diplomës. Programi i studimit MPTIAF përmban në planin mësimor informacionin e nevojshëm për: – grupin e lëndëve që studenti kryen çdo semestër dhe çdo vit akademik; – numrin total të krediteve që fiton studenti si dhe numrin e krediteve për secilën lëndë, si dhe orët në total për çdo lëndë në auditor / punë individuale. – ngarkesën mësimore të secilës lëndë, sipas veprimtarive mësimore: leksion, seminar, laborator etj. <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 14. Kurrikula e programit Teknologji Informacioni e aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidenca 19.1-19.6 syllabuse</i> <i>4. Evidencë shtesë për syllabuset</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit,	Nga shqyrtimi i rregullores së UET, rregullores së programit të studimit MPTIAF apo dokumentit D.I mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve, GVJ konstaton se në mënyrë të përmbledhur thuhet se: <i>Në këtë program studimi mund të pranohen ata kandidatë që kanë përfunduar ciklin e parë bachelor, brenda ose jashtë vendi, dhe plotësojnë kriteret e</i>

transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	<i>pranimi të shpallura nga UET për vitin akademik përkatës, ndërsa në dokumentin mbi përzgjedhjen e aplikantëve nga komisioni 2022-2023, paraqitet qartë mënyra e vlerësimit të kandidatëve:</i> - Programi i studimit në nivelin Bachelor: - o 1 pikë - programe të përafërta me informatikën apo financën dhe - o 2 pikë - program studimi në informatikë apo financë - Eksperienca të mëparshme: 1-5 pikë - Aftësi të ndërveprimit personal: 1-5 pikë Nga shqyrtimi i rregullores së UET, Neni 35 dhe rregullores së programit të studimit MPTIAF, pika 9, rezulton se përshkruhet qartë procedura e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 27.1. Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimi të studentëve.pdf</i> <i>Evidencë 27.3. Dokument mbi përzgjedhjen e aplikantëve nga komisioni 2022-2023.pdf</i> <i>28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.pdf</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në rregulloren e programit të studimit, si dhe në syllabuset e lëndëve, paraqitet informacion i hollësishëm mbi detyrimin e frekuentimit / ndjekjes së programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, etj. Syllabuset e lëndëve janë hartuar sipas formatit të miratuar sipas VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të ndryshuar dhe informojnë në lidhje me detyrimin për frekuentimin/ ndjekjen e programit nga studenti, mënyrën e vlerësimit të dijeve, literaturën, pedagogun e lëndës etj. GVJ konstaton se në një pjesë të konsiderueshme të syllabuseve: - mungon tipologjia e lëndës - literatura e detyruar është në gjuhë të huaj, megjithatë studentëve iu vihen në dispozicion edhe prezantime ppt në gjuhën shqipe të përgatitura nga pedagogu i lëndës - ka mospërputhje mes ngarkesës dhe/ose veprimtarive

	mësimore të paraqitura në syllabus me atë që është miratuar në planin mësimor - ka mospërputhje mes masës së frekuentimit të detyrueshëm që reflektohet në syllabuse dhe në rregulloren e UET (pika 25.2 - 75%) me masën e frekuentimit që Evidencaketohe në faqen ëeb të UET dhe rregulloren e MPTIAF (pika 6.1.2 - 80%) Bazuar në planin mësimorë, GVJ konstaton se ngarkesa e shprehur në kolonën <i>“Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor”</i> nuk reflektohet në një pjesë të konsiderueshme të syllabuseve. <u>GVJ rekomandon</u> të shtohet tipologjia e lëndës, të rakordohet mospërputhja e ngarkesës dhe/ose veprimtarive mësimore që reflektohen në syllabus-e me atë që është miratuar në planin mësimor, të azhornohet masa e duhur e frekuentimit të detyrueshëm të procesit mësimor (75% ose 80%) dhe të reflektohet në syllabus ngarkesa e shprehur në kolonën <i>“Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor”</i>. <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 19. Format i Syllabusit shqip_anglisht_vkm 41_2018.pdf</i> <i>Evidenca 19.1-19.6 syllabuse</i> <i>4. Evidencë shtesë për syllabuset</i> https://uet.edu.al/master-profesional/
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në IAL janë të përcaktuara procedurat që ndiqen për përmirësimet dhe ndryshimet në përmbajtjen e programit të studimit, në fund të çdo viti akademik. Bazuar dhe në rregulloren e studimeve MPTIAF, rishikimi i programit të studimit MPTIAF (kurrikulës) propozohet nga DIT apo Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave në konsultim me Bordet e Tregut të Punës dhe i përcillet për miratim instancave më të larta, Dekanatit dhe Senatit Akademik. Përditësimi i programeve të lëndëve që janë pjesë e programit të studimit propozohet nga personeli akademik i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i njësisë bazë që e ofron atë lëndë. Rishikimi mund të bëhet vetëm para fillimit të vitit të ri akademik.

	<i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit II.3, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> - <i>DIT, si njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit MPTIAF, disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</i> - <i>Plani mësimor përfshin informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/punë individuale.</i> - <i>UET ofron të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</i> - <i>GVJ rekomandon të shtohet tipologjia e lëndës, të rakordohet mospërputhja e ngarkesës dhe/ose veprimtarive mësimore që reflektohen në syllabus-e me atë që është miratuar në planin mësimor, të azhurnohet masa e duhur e frekuentimit të detyrueshëm të procesit mësimor (75% ose 80%) dhe të reflektohet në syllabus ngarkesa e shprehur në kolonën "Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor".</i> - <i>Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe	GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve dhe përmbajtja e veprimtarive të paraqitura në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve mundësojnë përgatitjen e studentëve me aftësitë dhe dijet e nevojshme teorike dhe praktike për studime të mëtejshme apo punësim në tregun e punës vendas dhe jashtë. Në kurrikulën e

aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	programit të studimit MPTIAF është parashikuar zhvillimi i praktikës profesionale si lëndë apo veprimtari formuese. Studentët kanë mundësi punësimi të menjëhershme pranë Bankës Credins, me të cilën është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për hapjen e këtij programi studimi dhe zhvillimin e praktikës. <i>Evidencë 14. Kurrikula e programit Teknologji Informacioni e aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidenca 19.1-19.6 syllabuse</i> <i>4. Evidencë shtesë për syllabuset</i> <i>Evidencë 34.1. Marrëveshje bashkëpunimi UET dhe Credins në funksion të programit.pdf</i> <i>Evidencë 29.1. Vërtetim punësimi i studentëve nga Credins.pdf</i>																									
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.	Mbështetur në shqyrtimin e planit mësimor të programit MPTIAF u evidentua shpërndarja e ngarkesës mësimore në 4 semestrat e realizimit të programit, e cila është e balancuar për çdo semestër. Ngarkesa mësimore javore në auditor është <table><tr><td>1. Semestri I</td><td>30 kredite</td><td>15 javë</td><td>20 orë/javë</td><td></td></tr><tr><td>2. Semestri II</td><td>30 kredite</td><td>15 javë</td><td>20 orë/javë</td><td></td></tr><tr><td>3. Semestri III</td><td>30 kredite</td><td>10 javë</td><td>17 orë/javë</td><td>4 javë</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td>16 orë/javë</td><td></td></tr><tr><td>4. Semestri IV</td><td>30 kredite</td><td>15 javë</td><td></td><td></td></tr></table> Bazuar në planin mësimorë dhe informacionin shtesë të kërkuar në lidhje me syllabuset e Praktikë/internship dhe Punim Diplome, GVJ konstaton se për të përlllogaritur ngarkesën javore në semestrin e IV-ët mungon informacion për javët kur zhvillohet Praktikë/internship dhe javët ku shtrihen seancat metodologjike. Nëse shqyrtojmë ngarkesën totale të lëndës dhe atë javore mund të kuptojmë se lënda Praktikë/internship shtrihet në 6 javë me një ngarkesë 40 orë/javë, ndërsa Punim Diplome shtrihet në 6 javë me një ngarkesë 2 orë/javë. Pra, gjatë javëve që studentët zhvillojnë praktikën profesionale në Bankën Credins zhvillojnë edhe 2 orë të tjera për Punim Diplome, në total 42 orë/javë për 6 javë dhe 2 orë/javë për 7 javë. GVB, si evidencë për planin mësimor të miratuar, ka përdorur formatin e tabelave përmbledhëse të ASCAL, rrjedhimisht GVJ nuk është në gjendje të vlerësojë nëse formati institucional i planit mësimor të UET ka informacion më të detajuar në lidhje me ngarkesën javore totale për çdo semestër apo numrin e javëve për semestër. Shpërndarja e lëndëve në semestra mundëson arritjen e	1. Semestri I	30 kredite	15 javë	20 orë/javë		2. Semestri II	30 kredite	15 javë	20 orë/javë		3. Semestri III	30 kredite	10 javë	17 orë/javë	4 javë				16 orë/javë		4. Semestri IV	30 kredite	15 javë		
1. Semestri I	30 kredite	15 javë	20 orë/javë																							
2. Semestri II	30 kredite	15 javë	20 orë/javë																							
3. Semestri III	30 kredite	10 javë	17 orë/javë	4 javë																						
			16 orë/javë																							
4. Semestri IV	30 kredite	15 javë																								

	objektivave formues të programit të studimit. Ngarkesa totale vjetore e orëve në auditor dhe orë pune të pavarur është 1500 orë për secilin prej viteve dhe raporti orë në auditor/punë e pavarur e studentit plotëson kornizën ligjore në fuqi. <i>Evidencë 14.2 Plani mësimor i programit Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>4. Evidencë shtesë për syllabuset Seancat metodologjike.pdf</i> <i>4. Evidencë shtesë për syllabuset Praktike Profesionale.pdf</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GJV konstaton se shpërndarja e ngarkesës mësimore në të 4 semestrat e realizimit të programit është e balancuar. Evidencaeruar strukturës së planit mësimor të programit MPTIAF evidentohet se gjatë vitit të parë të studimeve, lëndët me natyrë karakterizuese (7 lëndë) zënë pjesën më të madhe të programit nëpërmjet të cilave sigurohet aftësi, kompetenca dhe formim i thelluar profesional. Gjithashtu në këtë vit trajtohen edhe lëndët e formimit bazë (1 lëndë) dhe lëndë ndërdisiplinore (2 lëndë). Ndërkohë që në vitin e dytë rritet përqindja e njohurive dhe aftësive të lëndëve që lidhen me natyrën ndërdisiplinore dhe plotësuese. Struktura, lëndët dhe raporti teori-praktikë (474 orë/630 orë) janë në përputhje me profilin e programit të studimit. <i>Evidencë 17. Studimi për tregun e punës.pdf</i> <i>Evidencë 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit.pdf</i> <i>Evidencë 14.2 Plani mësimor i programit Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 52.Procedura për ndryshimin e kurrikulës (Tabela 11).pdf</i> <i>Evidencë 12.6. Mbledhje e hapur.pdf</i> <i>20. Evidencë shtesë për rekomandime nga studentët në lidhje me programin e studimit MPTIAF.pdf</i> <i>1. Evidencë shtesë për ngjashmëri 70% me programe vendase ose të huaja .pdf</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues,	Në këtë program studimi, gjatë 2 viteve akademike zhvillohen 1140 orë mësimore në auditor përkatësisht: - 352 orë leksion - 158 orë seminare - 56 orë ushtrime/laboratore - 334 orë forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të

transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor - 240 orë praktikë profesionale - 1860 orë mësimore punë e pavarur Gjatë takimeve me personelin akademik dhe me studentët e programit të studimit, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohet se raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve dhe mobilitet gjatë studimit, si dhe aftësimin e tyre për tregun e punës në fushën e teknologjisë së informacionit të aplikuar në financë. <u>GVJ rekomandon që DIT të punojë për rritjen e mobiliteteve në kuadër të bashkëpunimeve në projekte Erasmus+ që lidhen ngushtë me fushën e këtij programi studimi.</u> <i>Evidencë 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit.pdf</i> <i>Evidencë 14.2 Plani mësimor i programit Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 52.Procedura për ndryshimin e kurrikulës (Tabela 11).pdf</i> <i>Evidencë 43.1. Raporti i mobiliteteve_staf_studentë.pdf</i> <i>Evidencë 43.3. Marrëveshjet aktive për mobilitetin e personelit akademik.pdf</i>
Kriteri 5. Syllabusët (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në IAL janë të mirëpërcaktuara procedurat që ndiqen për përmirësimet dhe ndryshimet në planin mësimor të programit të studimit dhe syllabusët e programit të studimit. Përditësimi i programeve të lëndëve që janë pjesë e programit të studimit MPTIAF mund të propozohet nga personeli akademik i lëndës, departamenti, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave apo Bordet e Tregut të Punës si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës. Pasi shqyrtohet në Departament dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave dërgohet për miratim në mbledhjen e Dekanatit dhe më pas në Senatin Akademik të UET vetëm përpara fillimit të vitit të ri akademik. <u>(Rregullore e programit MPTIAF, pika 10).</u> <u>GVJ nuk evidentoi ndryshime në dokumentacion në përputhje me LAL 80/2015, Neni 35, Pika 4.</u> <i>Evidencë 7.1. Rregullore e programit të studimit Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (anglisht).pdf</i> <i>Evidencë 39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.pdf</i>

	<i>Evidencë 37. Formati i raportit për vlerësimin e silabuseve.pdf</i> <i>52.Procedura për ndryshimin e kurrikulës (Tabela 11).pdf</i> <i>Evidenca 19.1-19.6 syllabuse</i> <i>4. Evidencë shtesë për syllabuset</i> <i>Evidencë 24. Lista e azhurnimit te bibliotekes per kete program studimi.pdf</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit MPTIAF, bazohet në: - VKM-në nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, - në Rregulloren e UET si edhe - në Rregulloren e Programit të Studimit MPTIAF ku parashikohen aftësitë dhe kompetencat që do të përfitojnë studentët pas përfundimit me sukses të programit të studimit. <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 7.1. Rregullore e programit të studimit Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (anglisht).pdf</i> <i>Evidenca 19.1-19.6 syllabuse</i> <i>4. Evidencë shtesë për syllabuset</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit jep mundësi të mëtejshme studimi dhe punësimi të studentëve në përputhje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. <i>Evidencë 14. Kurrikula e programit Teknologji Informacioni e aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>20. Evidencë shtesë për rekomandime nga studentët në lidhje me programin e studimit MPTIAF.pdf</i> <i>Evidencë 29.1. Vërtetim punësimi i studentëve nga Credins.pdf</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-7 të standardit II.4, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> - Shpërndarja e lëndëve dhe përmbajtja e veprimtarive të paraqitura në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve mundësojnë përgatitjen e studentëve me aftësitë dhe dijet e nevojshme teorike dhe praktike për studime të mëtejshme apo punësim në tregun e punës vendas dhe jashtë. - Përmbajtja e programit të studimit siguron përfitim të njohurive, aftësive, si dhe kompetencave të synuara. - Përmbajtja e programit të studimit jep mundësi të

	<i>mëtejshme studimi dhe punësimi të studentëve në përputhje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës.</i> - <i>GVJ rekomandon që DIT të punojë për rritjen e mobiliteteve në kuadër të bashkëpunimeve në projekte Erasmus+ që lidhen ngushtë me fushën e këtij programi studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	GVJ, nga vizita në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstaton se për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit në raport të drejtë me kërkesat e tregut të punës, IAL konsultohet dhe bashkëpunon ngushtë me Bordin e Tregut të Punës si dhe me institucionin financiar të Bankës Credins, duke qenë se ky program studimi është iniciuar pikërisht nga marrëveshja e bashkëpunimit që ka me UET. Në kuadër të këtij përmirësimi, GVJ konstaton se departamenti zhvillon cdo vit takime me biznesin dhe institucionet publike në aktivitetin e quajtur "HR Club". Kjo strategji funksionimi është në përputhje të plotë edhe me procedurën e përkshuar në Statutin e UET. <i>Evidencë 12.1. Bordi i tregut të Punës DIT.pdf</i> <i>Evidencë 17. Studimi për tregun e punës.pdf</i> <i>Evidencë 2. Statuti UET_struktura organizative aktuale_shqip.pdf</i> <i>Evidencë 12.4. HR club 2023-2024.pdf</i> <i>Evidencë 12.4.1. HR club 2022-2023.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të	Nga vizita në institucion si dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ konstaton se një rol të rëndësishëm në përmirësimin e programit të studimit luajnë studentët me anë të strukturave të tilla si ajo e rrjeteve ALUMNI, e Bordit të Tregut të Punës si dhe e Këshillit Studentor. Ky i fundit është një organ i pavarur dhe koordinon përfaqësimin e studentëve në organet drejtuese të UET duke luajtur një rol të rëndësishëm në

studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	propozimin e zgjidhjeve të problematikave të ndryshme në lidhje me planet mësimorë, programet e studimeve, rregulloret etj. Gjithashtu, nga takimi me studentët, GVJ konstaton se ato janë pjesë e takimeve të vazhdueshme që realizohen në departament për shprehjen dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme që ato mund të kenë. <i>Evidencë 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf</i> <i>Evidencë 12.1. Bordi i tregut të Punës DIT.pdf</i> <i>Evidencë 12.6. Mbledhje e hapur.pdf</i> <i>Evidencë 3.3. Vendimi nr 8, date 06.07.2023 Per miratimin e amendimit te Planit strategjik 2021-2025.pdf</i> <i>20. Evidencë shitesë për rekomandime nga studentët në lidhje me programin e studimit MPTIAF.pdf</i> <i>Evidencë 55.2. D.III Mbi përfshirjen e studentëve në qeverisjen e UET.pdf</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Ashtu siç u theksua edhe më lart, bazuar në Statutin e UET, DIT në komunikim të vazhdueshëm me Bordin e Tregut të Punës, por edhe me biznese apo institucione me interes, realizon konsultime për përmbushjen e nevojave të tregut të punës nëpërmjet përditësimeve apo përshtatjeve që mund t'i bëhen programit të studimit për të arritur objektivat dhe rezultatet e të nxënit. <i>Evidencë 12.1. Bordi i tregut të Punës DIT.pdf</i> <i>Evidencë 17. Studimi për tregun e punës.pdf</i> <i>Evidencë 2. Statuti UET_struktura organizative aktuale_shqip.pdf</i> <i>Evidencë 3.3. Vendimi nr 8, date 06.07.2023 Per miratimin e amendimit te Planit strategjik 2021-2025.pdf</i> <i>Evidencë 15.1. Objektivat dhe rezultatet e të nxënit.pdf</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-3 të standardit II.5, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> - <i>GVJ konstaton se një rol të rëndësishëm në përmirësimin e programit të studimit luajnë studentët me anë të strukturave të tilla si ajo e rrjeteve ALUMNI, e Bordit të Tregut të Punës si dhe e Këshillit Studentor.</i> - <i>GVJ konstaton se departamenti zhvillon cdo vit takime me biznesin dhe institucionet publike në aktivitetin e quajtur "HR Club".</i> - <i>GVJ konstaton se studentët janë pjesë e takimeve të</i>

	<i>vazhdueshme që realizohen në departament për shprehjen dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme që ato mund të kenë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit konkludohet se programi i studimit MP "TIAF" i pajisë të diplomuarit me njohuri të thelluara profesionale mbi teknologjinë e informacionit të aplikuar në financë. Programi MP "TIAF" synon të formojë ekspertë dhe specialistë në aspektet teorike dhe aplikative. Këto shprehen në Rregulloren e UET, <i>Neni 3, pika 3.8, dhe Rregulloren e MP "TIAF", pika 3.3</i>, ku specifikohen në detaj objektivat për programin e studimit si dhe shihet qartë përputhja që ato kanë me objektivat madhore të UET, të shprehura në Statutin e tij, <i>Neni 5 dhe 6</i>. <i>Evidencë 2. Statuti UET_struktura organizative aktuale_shqip.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 15.1. Objektivat dhe rezultatet e të nxënësve.pdf</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Nga takimet me drejtuesin e njësisë kryesore, drejtuesin e njësisë bazë, stafin e përfshirë në program dhe studentët u konstatua se njësia kryesore dhe njësia bazë bashkërendojnë dhe administrojnë veprimtaritë e mësimdhënies, si edhe veprimtaritë kërkimore shkencore duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik. <i>Evidencë 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit.pdf</i> <i>Evidencë 43. Të dhëna mbi kerkimin shkencor të stafit – Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë.pdf</i> <i>Evidencë 43.1. Raporti i mobiliteteve_staf_studentë.pdf</i> <i>Evidencë 43.3. Marrëveshjet aktive për mobilitetin e personelit akademik.pdf</i>

	<i>Evidencë 23. Evidencë për avancimin akademik të stafit akademik.pdf</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Mbështetur në Rregulloren e MP "TIAF" është evidentuar në pikën 8-Diplomim: "Diplomimi bëhet me përgatitjen edhe mbrojtjen e një punimi diplome ose nëpërmjet Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP)", duke i mundësuar studentëve të përfshihen në studim dhe aktivitete kërkimore. Gjithashtu, mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar dhe RVB, GVJ konstaton se katër studentë të programit MP "TIAF" kanë qenë pjesë e aktivitetit DSSH Junior në tetor 2024, me një punim shkencor mbi sigurinë kibernetike. Mbështetur në dokumentacion dhe takimet e zhvilluara me studentët e programit MP "TIAF", u konstatua një nivel i ulët i përfshirjes së tyre në aktivitete kërkimore. <u>GVJ rekomandon rritjen e mundësisë së pjesëmarrjes në konferenca periodike studentore me qëllim nxitjen për përfshirje dhe angazhim në studime dhe aktivitete kërkimore.</u> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit.pdf</i> <i>Evidencë 55. Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)_2018-2024.pdf</i> <i>Evidencë 43.1. Raporti i mobiliteteve_staf_studentë.pdf</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Nga takimi i zhvilluar me stafin e përfshirë në program dhe përfaqësues të zyrës së kërkimit shkencor, si edhe dokumentacionin e vënë në dispozicion u konstatua se pedagogët e DIT dhe më gjerë inkurajohen nga universiteti me anë të granteve dhe shpërblimeve për publikime shkencore dhe avancimin e titujve akademike. <i>Evidencë 12. Aktmarreveshje grant kerkimor.pdf</i> <i>Evidencë 13. Shperblim per arritje ne kerkimin shkencor.pdf</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-4 të standardit II.6, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> - Programi i studimit MPTIAF i pajis të diplomuarit me njohuri të thelluara profesionale mbi teknologjinë e informacionit të aplikuar në financë dhe shihet qartë përputhja e objektivave kryesore të programit me objektivat madhore të UET, të shprehura në Statutin e tij.

	- Njësia kryesore dhe njësia bazë bashkërendojnë dhe administrojnë veprimtaritë e mësimdhënies, si edhe veprimtaritë kërkimore shkencore duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik. - <u>GVJ rekomandon</u> rritjen e mundësisë së pjesëmarrjes në konferenca periodike studentore me qëllim nxitjen për përfshirje dhe angazhim në studime dhe aktivitete kërkimore. - Pedagogët e DIT dhe më gjerë inkurajohen nga universiteti me anë të granteve dhe shpërblimeve për publikime shkencore dhe avancimin e titujve akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Evidencaeruar dokumentacionit dhe takimeve të zhvilluara në institucion u konstatua se departamenti nëpërmjet konferencës vjetore ndërkombëtare “Ditët e Studimeve Shqiptare” (DSSH), të organizuar nga UET, ka zbatuar dhe ka mbështetur kërkime në fushën e edukimit, teknologjisë së informacionit dhe inovacionit, por edhe në shumë disiplina të tjera që ofron universiteti, të cilat mbështesin proceset kërkimore të stafit akademik. Departamenti gjithashtu, në kuadër të ndërkombëtarizimit, nëpërmjet Programit Evropian Erasmus+ ka bashkëpunuar dhe ka shkëmbyer përvoja profesionale me disa universitete evropiane që lehtësojnë shkëmbimet studentore dhe të stafit akademik, me qëllim rritjen e cilësisë së programeve që ofrohen nga UET. <u>GVJ rekomandon përfshirje më të lartë të studentëve të MPTIAF në eksperiencën mobiliteti Erasmus +.</u> <i>Evidencë 3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025.pdf</i> <i>Evidencë 4. Plan Strategjik për zhvillimin e programit të studimit.pdf</i> <i>Evidencë 35. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit - Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë.pdf</i>

	<i>Evidencë 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit.pdf</i> <i>Evidencë 55. Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)_2018-2024.pdf</i> <i>Evidencë 55.1. Kalendari i aktiviteteve 2023-2024.pdf</i> <i>Evidencë 43.1. Raporti i mobiliteteve_staf_studentë.pdf</i> <i>Evidencë 43.3. Marrëveshjet aktive për mobilitetin e personelit akademik.pdf</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Nga vizita në institucion, si edhe nga kontrolli i dokumentacionit shoqërues, konstatohet se personeli akademik është pjesë e aktiviteteve kërkimore shkencorë të cilat reflektohen në analizën vjetore të DIT, kalendarin e aktiviteteve, mobilitetet staf/studentë etj. Megjithatë, <u>GVJ rekomandon përfshirjen në një masë më të lartë të studentëve të MPTIAF në aktivitete kërkimore shkencore.</u> <i>Evidencë 33. Të dhëna për trajnime profesionale.pdf</i> <i>Evidencë 35. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit - Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë.pdf</i> <i>Evidencë 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit.pdf</i> <i>Evidencë 55. Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)_2018-2024.pdf</i> <i>Evidencë 55.1. Kalendari i aktiviteteve 2023-2024.pdf</i> <i>Evidencë 43.1. Raporti i mobiliteteve_staf_studentë.pdf</i> <i>Evidencë 43.3. Marrëveshjet aktive për mobilitetin e personelit akademik.pdf</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Nga vizita në institucion, si edhe nga kontrolli i dokumentacionit shoqërues, rezultoi se njësia përgjegjëse ka organizuar aktivitete mësimore dhe kërkimore shkencore që të ndihmojë personelin akademik që të përmbushin arritjen e objektivave. <i>Evidencë 3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025.pdf</i> <i>Evidencë 55.1. Kalendari i aktiviteteve 2023-2024.pdf</i> <i>Evidencë 33. Të dhëna për trajnime profesionale.pdf</i> <i>Evidencë 55. Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)_2018-2024.pdf</i> <i>Evidencë 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit.pdf</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, si dhe nga takimet në institucion u konstatua se programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Punësimi i studentëve në përputhje me diplomën MP

ndërkombëtar të punës.	“TIAF” për vitin 2023-2024 është 6 studentë nga 6 në total (rreth 100%). <i>Evidencë 29. Te dhena per diplomimin dhe punesimin e studenteve</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Nuk aplikohet në këtë program studimi.
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Nuk aplikohet në këtë program studimi.
Konkluzione	Bazuar në analizën e kriterëve 1-6 të standardit II.7, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se: - Departamenti nëpërmjet konferencës vjetore ndërkombëtare “Ditët e Studimeve Shqiptare” (DSSH), të organizuar nga UET, ka zbatuar dhe ka mbështetur kërkime në fushën e edukimit, teknologjisë së informacionit dhe inovacionit, por edhe në shumë disiplina të tjera që ofron universiteti, të cilat mbështesin proceset kërkimore të stafit akademik. - Në kuadër të ndërkombëtarizimit, nëpërmjet Programit Evropian Erasmus+, departamenti ka bashkëpunuar dhe ka shkëmbyer përvoja profesionale me disa universitete evropiane me qëllim rritjen e cilësisë të programeve që ofrohen nga UET. - <u>GVJ rekomandon përfshirje më të lartë të studentëve të</u>

	<i>MPTIAF në eksperiencë mobiliteti Erasmus +.</i> - <i>Personeli akademik është pjesë e aktiviteteve kërkimore shkencore të cilat reflektohen në analizën vjetore të DIT, kalendarin e aktiviteteve, mobilitetet staf/studentë etj. Megjithatë, GVJ rekomandon përfshirjen në një masë më të lartë të studentëve të MPTIAF në aktivitete kërkimore shkencore.</i> - <i>Njësia përgjegjëse ka organizuar aktivitete mësimore dhe kërkimore shkencore që të ndihmojë personelin akademik që të përmbushin arritjen e objektivave.</i> - <i>Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në UET, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit MPTIAF zhvillon forma të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave lëndore, praktikave profesionale të miratuara nga IAL bazuar në rregulloren e UET. Personeli akademik është mbështetur nga UET në rritjen akademike dhe profesionale dhe është udhëzuar mbi metodat e reja të mësimdhënies innovative.

	<i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 7.1. Rregullore e programit të studimit Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (anglisht).pdf</i> <i>Evidencë 14.2. Plani mësimor i programit Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 19. Format i Syllabusit shqip_anglisht_vkm 41_2018.pdf</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Nga bisedat që realizoi GJV me anëtarët e personelit akademik efektiv, si edhe me studentët e programit të studimit, rezultoi se personeli akademik u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. Gjithashtu u konstatua se gjatë zhvillimit të mësimdhënies përdoren edhe mjete audio vizuale jo vetëm nga lektorët, por edhe nga studentët gjatë prezantimit të detyrave të kursit, punimeve në grup, apo edhe atyre individuale. UET ka infrastrukturën e nevojshme për të ofruar forma dhe metoda të larmishme të mësimdhënies dhe mësimnxënies ndërthurur dhe me aksesin e librave në bilbliotekën online. <i>Evidencë 3.5. Dokumenti SCL Teaching and Assessment Policy.pdf</i> <i>Evidencë 3.6. Vendimi nr 9, date 06.07.2023 Per miratimin e dokumentit SCL Teaching and Assessment Policy.pdf</i> <i>Evidencë 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit - Rr. "Xhanfize Keko".pdf</i> <i>Evidencë 45. Inventari i teksteve në Bibilotekë për fushën e programit të studimit teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë.pdf</i> <i>Evidencë shtesë 24. Lista e azhornimit te bibliotekes per kete program studimi.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Institucioni e mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. UET zbaton një politikë të mirëpërcaktuar për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit akademik. Format e mbështetjes janë: - Mobilitete ndërkombëtare - Projekte të Komunitetit European - Udhëzues i metodave inovative të mësimdhënies - Leksione të hapura dhe trajnime - Kualifikime dhe specializime jashtë institucionit

	<i>Evidencë 3.5. Dokumenti SCL Teaching and Assessment Policy.pdf</i> <i>Evidencë 33. Të dhëna për trajnime profesionale.pdf</i> <i>Evidencë 43.1. Raporti i mobiliteteve_staf_studentë.pdf</i> <i>Evidencë 43.3. Marrëveshjet aktive për mobilitetin e personelit akademik.pdf</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në UET, GVI konstaton se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në MPTIAF, ka formimin e duhur dhe në përputhje me fushën e programit të studimit. Metodat e mësimdhënies të përdorura nga stafi akademik përshkruhen edhe në seksionin përkatës në syllabusin e lëndës. Gjatë takimeve të zhvilluara në institucion u konkludua mbështetje në marrëdhëniet e krijuara me respekt të ndërsjellët mes dekanit, përgjegjësit të departamentit, stafit akademik, stafit administrativ dhe studentëve. <i>Evidencë 20. CV (Stafi).pdf</i> <i>Evidencë 19. Formati i Syllabusit shqip_anglisht_vkm 41_2018.pdf</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Rezultatet e anketimeve dhe vlerësimeve periodike të anketës vlerësuese të studentit për stafin akademik, ku përfshihen dhe format dhe metodat e mësimdhënies, i komunikohen çdo pedagogu. UET ka zhvilluar mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë, që janë rregulluar me rregulloret përkatëse, zyrat për monitorimin e brendshëm të cilësisë dhe raportimi përkatës pranë njësive kryesore dhe bazë. Në kuadër të përmirësimit të programit, IAL nxit dhe përfshin në diskutime dhe studentët nëpërmjet: - Anketimit për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit nga studentët e regjistruar - Përshirjen në strukturat e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë - Vëzhgimi i drejtpërdrejtë i pedagogut gjatë procesit mësimorë <i>Evidencë 40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët_online.pdf</i> <i>20. Evidencë shtesë për rekomandime nga studentët në lidhje</i>

	<i>me programin e studimit MPTIAF.pdf</i> <i>Evidencë 30.4. Vendim Senati mbi përbërjen e KSBC.pdf</i> <i>Evidencë 30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC.pdf</i> <i>Evidencë 30.15. Shpërndarja e raportit dhe ekstrakt raporti i fokus grupeve.pdf</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Në nivel institucioni puna për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës-akademik drejtohet nga KSBC. Kjo njësi ka rregulloren e saj, ku përcaktohet edhe mënyra e organizimit dhe detyrat që kanë njësitë kryesore dhe bazë. GVJ konstatoi se garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies në programin e studimit, i cili plotësohet nga studentët në mënyrë periodike. Ky pyetësor është anonim dhe gjithë procesi drejtohet dhe monitorohet nga KSBC. Rezultatet e pyetësorit, të paraqitura të përmbledhura në raport dhe që i komunikohen personelit akademik, shërbejnë si bazë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo anketë mundëson gjithashtu rritjen e vetëdijes së personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në mësimdhënie. Nga takimet në institucion, GVJ u informua se personeli akademik ka në fokusin e tij përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Në mënyrë të veçantë në këtë drejtim kanë kontribuar mobilitetet e personelit akademik në universitete jashtë vendit. <i>Evidencë 8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë. pdf</i> <i>Evidencë 30.1. Plani veprimit KSBC.pdf</i> <i>Evidencë 30.3. Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2021-2025.pdf</i> <i>Evidencë 30.15. Shpërndarja e raportit dhe ekstrakt raporti i fokus grupeve.pdf</i> <i>Evidencë 43.1. Raporti i mobiliteteve_staf_studentë.pdf</i> <i>Evidencë 43.3. Marrëveshjet aktive për mobilitetin e personelit akademik.pdf</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-6 të standardit III.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> - Personeli akademik i programit të studimit MPTIAF

	zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive të miratuara nga IAL nëpërmjet rregulloreve specifike. - UET angazhohet në mbështetjen e personelit akademik për përmirësimin e kompetencave të tyre didaktike. DIT vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë dhe reflektuar mendimin e studentëve. - Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) në UET organizon, drejton dhe monitoron përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në nivel institucional.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e institucionit, atë të programit të studimit dhe syllabus-et e lëndëve të cilat u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. Vlerësimi i kontrollit të dijes bëhet me notë, ku 5 është nota kaluese dhe 10 është vlerësimi më i lartë. <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 19. Formati i Syllabusit shqip_anglisht_vkm 41_2018.pdf</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari	Nga bisedat që realizoi grupi i punës së vlerësimit të jashtëm me anëtarët e personelit akademik efektiv, si edhe me studentët e programit të studimit, rezultoi se pedagogët në fillim të çdo lënde/moduli informojnë studentët për format e vlerësimit të njohurive dhe aftësive, për metodologjinë e testimit, për detyrimet lëndore së bashku me afatet për secilin detyrim që mbështesin vlerësimin formues dhe përmbledhës të studentëve.

i lëndës/modulit.	
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Konstatohet se, nga shqyrtimi i dokumentacionit, vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Komponentët e vlerësimit, për lëndë të tipologjisë II, sipas peshës përkatëse në përqindje të pasqyruara në syllabus-et e lëndëve janë: - vlerësimi i vazhduar në seminare (10%) të notës përfundimtare - detyra kursi (20%) të notës përfundimtare - provim i ndërmjetëm (30%) të notës përfundimtare - provim përfundimtar (40%) të notës përfundimtare ndërsa për lëndën Praktikë/internship vlerësimi i studentit sipas peshës përkatëse në përqindje është: - senacat në auditor (10%) të notës përfundimtare - CV, letër interesi dhe intervistë me shkrim (10%) të notës përfundimtare - mbrojtje dhe dokumentacion (80%) të notës përfundimtare <i>GVJ, në vazhdimësi edhe të analizës së realizuar në standardet më lartë, sugjeron t'i kushtohet vëmendje rekomandimeve të dhëna në standardin II.1, kriteri 3.</i> <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 19. Formati i Syllabusit shqip_anglisht_vkm 41_2018.pdf</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-3 të standardit III.2, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> - <i>Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e institucionit, atë të programit të studimit dhe syllabus-et e lëndëve të cilat u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik.</i> - <i>Pedagogët në fillim të çdo lënde/moduli informojnë studentët për format e vlerësimit të njohurive dhe aftësive, për metodologjinë e testimit, për detyrimet lëndore së bashku me afatet për secilin detyrim që mbështesin vlerësimin formues dhe përmblendhës të studentëve.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion GVJ konstaton se testimi dhe vlerësimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale realizohet përgjatë vitit akademik me qëllim që studentët të jenë të angazhuar përgjatë semestrit dhe të vlerësohen sipas disa kriterëve të parashikuara në rregulloren e studimeve. Siç është përmendur edhe më lart pedagogu i lëndës në vlerësimin përfundimtar mbështetet në vlerësimin e vazhduar në seminare, detyrën e kursit, provimin e ndërmjetëm dhe provimin përfundimtar. Këto forma testimi dhe detyrash u japin mundësinë të gjithë studentëve të shprehin aftësitë e tyre dhe të mbrojnë kompetencat e fituara gjatë procesit mësimor. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale parashikohet në të gjitha syllabuset e lëndëve. <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 19. Formati i Syllabusit shqip_anglisht_vkm 41_2018.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga bisedat që realizoi GVJ me anëtarët e personelit akademik efektiv, por edhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u konstatua se testimi dhe vlerësimi i njohurive në UET realizohet duke kombinuar metodat tradicionale (provimet me shkrim dhe ato me gojë), si dhe format elektronike si hartimi, dërgimi elektronik dhe prezantimi i detyrave/projekteve të kursit. UET përdor edhe metoda elektronike të vlerësimit nëpërmjet projektit Cleanscore nga Fondi Shqiptaro - Amerikan i Zhvillimit.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	GVJ konstaton se format e vlerësimit përfundimtar të lëndës janë të përcaktuara përgjithësisht në rregulloren e studimeve në UET, rregulloren e programit të studimit MPTIAF, si dhe në mënyrë më specifike në syllabus-in përkatës të lëndës. Në të njëjtën kohë forma e vlerësimit u bëhet e ditur studentëve në

	javën e parë mësimore nga pedagogu i lëndës. <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 19. Formati i Syllabusit shqip_anglisht_vkm 41_2018.pdf</i> <i>Evidencë 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve. pdf</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion GVJ konstaton se gjatë zhvillimit të lëndës stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente/feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen. Vlerësimi i komponentëve të vlerësimit përfundimtar shoqërohet me komente nga pedagogu/pedagogët e lëndës, ku qartësohen të gjitha kriteret e përdorura në vlerësim dhe studentët ballafaqohen me vlerësimin. Korrigjimi i provimit shoqërohet me komente në lidhje me gjetjet e pedagogut dhe arsyetimin e vlerësimit. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit u konstatua se në raste të nevojshme, pedagogu/pedagogët e lëndës janë të gatshëm të japin mbështetjen dhe sqarimet shtesë të nevojshme për studentët që e kërkojnë këtë, bazuar edhe në rregulloren e MPTIAF. <i>Evidencë 7.3. Formati i tezës së provimit përfundimtar.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në rregulloren e UET, Neni 33, janë përcaktuar masat që merren nga njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik që shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. DIT dhe personeli akademik bazohen në këtë rregullore lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes dhe të masave ndëshkuese në rast kopjimi gjatë procesit të provimit. Për sa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesit e DIT, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren (kryesisht të punimet e diplomave) të jenë autentike

	në ndihmë të të cilëve i vjen edhe platforma Turnitin. Testet e ndërmjetme dhe ai final administrohen nga prania në auditor e dy pedagogëve, të cilët janë përgjegjës për moslejimin e kopjimit. <i>Evidencë 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve.pdf</i> <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Nga vizita në institucion, si edhe nga kontrolli i dokumentacionit shoqërues rezultoi se vlerësimi përfundimtar bëhet në përputhje me rregulloren e studimeve në UET, rregulloren e programit të studimit MP "TIAF" si dhe sipas disa kriterëve të parashikuara për komponentët e vlerësimit në syllabuset e lëndëve. GVJ konstatoi, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, që vlerësimi kryhet në bazë notash nga 1 në 10. Nota më e ulët kaluese është nota 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga pedagogu i lëndës brenda dy javëve nga data e zhvillimit, përfshirë edhe seancat sqaruese, ndërsa në rastin e riprovimeve periudha kohore është një javë. <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	GVJ konstatoi gjatë takimit me studentët se ata ishin të informuar mbi të drejtën e tyre për ankimim, kjo e përcaktuar edhe në rregulloren e studimeve të UET, Neni 32, rregulloren e programit të studimit MP "TIAF", pika 5.8.1 dhe 5.8.2. Gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se studentët në përgjithësi merrnin përgjigje apo sqaronin çdo paqartësi të mundshme me pedagogët e lëndës pa patur nevojë të përshkallëzojnë kërkesat e tyre. <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion GVJ konstaton se procedura e ankimit e shprehur në rregulloren e UET është në përputhje të plotë me atë të parashikuar në rregulloren e MP "TIAF". Pas seancave sqaruese, nëse studenti ka bindje se vlerësimi i pedagogut nuk është korrekt, ai ka të drejtë t'i drejtojë DIT një

përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	kërkesë me shkrim ku sqaron arsyet mbi të cilat bazohet ankesa e tij. Pas marrjes së ankesës Drejtuesi i DIT ose Dekani, ngre një komision të përbërë nga tre pedagogë për rivlerësim, i cili do të jetë përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i ulët ose më i lartë se vlerësimi fillestar i ankimuar. <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-8 të standardit III.3, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> - <i>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale parashikohet në të gjitha syllabuset e lëndëve.</i> - <i>Testimi dhe vlerësimi i njohurive në UET realizohet duke kombinuar metodat tradicionale si dhe format elektronike.</i> - <i>Format e vlerësimit përfundimtar të lëndës janë të përcaktuara përgjithësisht në rregulloren e studimeve në UET dhe të programit të studimit MPTIAF, si dhe në mënyrë më specifike në syllabus-in përkatës të lëndës.</i> - <i>Gjatë zhvillimit të lëndës staf i akademik u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla për përmirësimin e performancës në të ardhmen.</i> - <i>Në rregulloren e provimeve të UET janë përcaktuar masat që merren nga njësiti përgjegjëse dhe personeli akademik që shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</i> - <i>Vlerësimi përfundimtar bëhet në përputhje me rregulloren e studimeve në UET, rregulloren e programit të studimit MPTIAF si dhe sipas disa kriterëve të parashikuara për komponentët e vlerësimit në syllabuset e lëndëve.</i> - <i>Studentët në përgjithësi marrin përgjigje apo sqarojnë çdo paqartësi të mundshme me pedagogët e lëndës pa patur nevojë të përshkallëzojnë kërkesat e tyre.</i>

Shkalla e përmbyshjes së standardit	Nuk përmbyshet	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	GVJ konstaton se program i studimit MPTIAF synon t'i përgatisë dhe formojë studentët me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme në menaxhimin e bazave të të dhënave, sigurinë e sistemeve dhe aplikacioneve, sigurinë kibernetike të organizatës, sigurinë e rrjetave kompjuterike etj. GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin dhe lëndë karakterizuese në fushën e teknologjisë së informacionit, specifiku në fushën e financës, si dhe përmbyllet me provimin përfundimtar/punimin e diplomës. Në këtë program studimi është parashikuar lënda “Praktikë Profesionale”, e cila ndihmon studentin të aplikojë në praktikë njohuritë e përfuara gjatë studimeve në një ambient real në tregun e punës. DIT mundëson për studentët krahas procesit mësimor dhe procesin e konsultimeve. Kjo kurrikul përgatit dhe mbështet studentët për thellimin e studimeve në ciklin master. <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 14. Kurrikula e programit Teknologji Informacioni e aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidenca 19.1-19.6 syllabuse</i> <i>4. Evidencë shtesë për syllabuset</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Ky program studimi synon krijimin dhe zhvillimin e aftësive specifike në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit dhe aftësi të tjera të vecanta kurrikulare si “Kriptografia dhe Ethical Hacking”, “Kontrolli dhe Auditimi i sigurisë në rrjetat kompjuterike”, “Praktikë/internship”. Njohuritë dhe aftësitë në fushën e TIK janë të thelluara dhe pjesë e programit të studimit. <i>Evidencë 14. Kurrikula e programit Teknologji Informacioni e aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i>

	<i>Evidenca 19.1-19.6 syllabuse</i> <i>4. Evidencë shtesë për syllabuset</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Nga takimi me studentët e programit, rezulton se në fillim të semestrit, studentëve iu ofrohet informacion rreth mënyrës së organizimit të lëndës, objektivat e lëndës dhe rezultatet e pritshme. Metodatat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale ju bëhen të njohura studentëve në përfundim të lëndës. Në këtë mënyrë u vihen në vëmendje konceptet dhe çështjet më të rëndësishme, si dhe detyrimet përmbyllëse dhe vlerësimi i tyre sipas kriterëve të parashikuara dhe prezantuar në syllabuset e lëndëve. GVJ u informua gjatë takimit me stafin akademik se studentët në mënyrë të vazhdueshme mbështeten, orientohen dhe udhëzohen nga ana e tyre në realizimin e detyrave të caktuara, pjesë e programeve mësimore të lëndëve të ndryshme. Detyrat/projektet e kursit në lëndët përkatëse janë një mundësi reale për zhvillimin e punës në grup. Gjithashtu në javët e fundit, pedagogët e lëndës informojnë studentët mbi kompetencat e fituara që duhet të demonstrojnë në provim. Studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi përfundimtar dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit/lëndës provimi përfundimtar. <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidenca 19.1-19.6 syllabuse</i> <i>4. Evidencë shtesë për syllabuset</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e	GVJ vlerëson se personeli akademik i programit të studimit MPTIAF transmeton dijet e tyre tek studentët duke demonstruar njohuritë dhe duke kryer praktika dhe teste laboratorike së bashku me studentët. Gjatë zhvillimit të orëve mësimore, studentët realizojnë prezantime apo detyra kursi dhe projekte të ndryshme të parashikuara dhe në syllabuset e të gjitha lëndëve. Studentët aplikojnë njohuritë e marra gjatë lëndëve në praktikatat lëndore dhe profesionale. Gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët, GVJ evidentoi se personeli akademik i programit të studimit MP "TIAF" në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukturon studentët në realizimin e detyrave të caktuara, pjesë e programeve mësimore të lëndëve të ndryshme. Detyrat/projektet e kursit në lëndët përkatëse janë një mundësi reale për zhvillimin

ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	e punës në grup për interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve të zbatimit real, në të cilat personeli akademik nxit studentët që ta trajtojnë studimin dhe gjetjen e zgjidhjes duke punuar në grup, mbështetur edhe në metodat e ndryshme që propozohen në SCL Teaching and Assessment Policy. Në të njëjtën kohë UET ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi me IAL në vend dhe jashtë, si dhe në kuadër të projekteve ERASMUS +, exchange dhe mobilitet, të cilat ndikojnë ndjeshëm në përmirësimin e formave të mësimdhënies. <i>Aktualisht nuk ka mobilitete aktive studentësh në këtë program studimi (Tabela 20). GVJ rekomandon që UET të shtojë angazhimin për pjesëmarrjen e studentëve në mobilitete në kuadër të projekteve ERASMUS +.</i> <i>Evidencë 43.3. Marrëveshjet aktive për mobilitetin e personelit akademik.pdf</i> <i>Evidencë 43.1. Raporti i mobiliteteve_staf_studentë.pdf</i> <i>Evidencë 55.1. Kalendari i aktiviteteve 2023-2024.pdf</i> <i>Evidencë 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit.pdf</i> <i>Evidencë 0.1. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë.pdf</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Evidencaeruar takimeve të zhvilluara me stafin akademik dhe studentët, si edhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni, u evidentua se FIIA/DIT nëpërmjet personelit akademik efektiv/ me kontratë të përfshirë ose jo në programin e studimit ka realizuar leksione të hapura që lidhen me teknologjinë e informacionit në përgjithësi, por edhe atë të aplikuar në financë në vecanti në kuadër edhe të marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka me Bankën Credins dhe institucione të tjera publike/private që operojnë në fushën e programit të studimit. <i>Evidencë 55.1. Kalendari i aktiviteteve 2023-2024.pdf</i> <i>Evidencë 34. Marrëveshje bashkëpunimi - lista UET.pdf</i> <i>Evidencë 32. Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale (Aneks Tabela 5).pdf</i>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara	Evidencaeruar takimeve të zhvilluara me stafin akademik, si edhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni (Tabela 22), GVJ konstaton se UET nxit përfshirjen e studentëve

kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	në zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore bazuar në Startegjinë e Kërkimit Shkencor në UET. Studentët që përmbyllin studimet me temë diplome janë pjesë e përzgjedhjes për botim të punimit të tyre në revistën shkencore të fakultetit, Ingenius. <i>Evidencë 38. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit.pdf</i> <i>Evidencë 0.1. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë.pdf</i>
Konkluzione	Bazuar në analizën e kriterëve 1-6 të standardit III.4, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se: - Programi i studimit MPTIAF synon t'i përgatisë dhe formojë studentët me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme në menaxhimin e bazave të të dhënave, sigurinë e sistemeve dhe aplikacioneve, sigurinë kibernetike të organizatës, sigurinë e rrjetave kompjuterike etj. - Ky program studimi synon krijimin dhe zhvillimin e aftësive specifike në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit dhe aftësi të tjera të vecanta kurrikulare si "Kriptografia dhe Ethical Hacking", "Kontrolli dhe Auditimi i sigurisë në rrjetat kompjuterike", "Praktikë/internship". - Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti analizohen në përfundim të lëndës si dhe studentët orientohen për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. - <u>GVJ rekomandon</u> që UET të shtojë angazhimin për pjesëmarrjen e studentëve në mobilitete në kuadër të projekteve ERASMUS +. - FIHA/DIT nëpërmjet personelit akademik efektiv / me kontratë të përfshirë ose jo në programin e studimit ka realizuar leksione të hapura që lidhen me teknologjinë e informacionit në përgjithësi, por edhe atë të aplikuar në financë në veçanti në kuadër edhe të marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka me Bankën Credins dhe institucione të tjera publike/private që operojnë në fushën e programit të studimit. - UET nxit përfshirjen e studentëve në zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore.

Shkalla e përmbyshjes së standardit	Nuk përmbyshet	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ konstaton se përmbyllja e studimeve në programin e studimit MPTIAF realizohet nëpërmjet një projekti profesional me karakter aplikativ/praktik ose nëpërmjet një Provimi të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP). Për secilin prej rasteve UET informon studentët për procedurën që duhet ndjekur. Megjithatë, UET duhet të marrë parasysh rekomandimet e Standardi II.1, kriteri 3. <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf</i> <i>Evidencë shtesë 5. PPP MP Fintech 2023-24.pdf</i> <i>4. Evidencë shtesë për syllabuset Seancat metodologjike.pdf</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, si dhe nga takimet në institucion konstatohet se DIT harton, në bashkëpunim me të gjithë stafin akademik, një program për provimin përfundimtar të diplomimit, që përmban lëndët dhe temat përkatëse për të cilat u vihen në dispozicion studentëve si dhe instruksionet e nevojshme për punimin e diplomës. <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf</i> <i>Evidencë shtesë 5. PPP MP Fintech 2023-24.pdf</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në	Nga bisedat që GVJ realizoi me anëtarët e personelit akademik efektiv u konstatua se PPP bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë gjithë viteve akademike duke përfshirë lëndë në

testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	bazë të rëndësisë dhe peshës specifike, kryesisht ato të kategorisë C, në trajtën e një rasti studimor. GVJ konstaton se në formatin e PPP: - Hyrja vlerësohet me 10% të notës përfundimtare - Analiza e rastit studimor vlerësohet me 70% të notës përfundimtare - Konkluzione vlerësohet me 20% të notës përfundimtare. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit të përgjithshëm përfundimtar përbëhet nga tre pedagogë. Evidencë 7.2. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve.pdf Evidencë 7.4. Format i Tezës së Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (MP).pdf Evidencë 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf Evidencë shtesë 5. PPP MP Fintech 2023-24.pdf
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstaton se rregulloret institucionale e parashikojnë mundësinë e përmbylljes së studimeve me temë diplome. Nga takimi me stafin akademik konstatohet se përmbyllja e studimeve të brezit të parë të studentëve është realizuar me anë të projekteve profesionale me karakter aplikativ/praktik. <i>Evidencë 5. RREGULLORE UET.pdf</i> <i>Evidencë 7. Rregullore programi Mp Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë (Shqip).pdf</i> <i>Evidencë 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf</i> <i>Evidencë 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin (Tabela 21).pdf</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstaton se në kuadër të marrëveshjes së ngushtë të bashkëpunimit që ekziston ndërmjet UET dhe Bankës Credins studentët e programit të studimit MPTIAF kanë të gjithë asistencën e duhur për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të	GVJ Evidencaeruar dokumentacionit të dorëzuar si dhe vizitës në institucion konstaton se në përfundim të provimit

përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. Në rastin e punimit të diplomës nota është measatare e vlerësimit të anëtarëve të konisionit të cilës i shtohet formulari i vlerësimit të udhëheqësit dhe oponentit për diplomën. Komisioni më pas plotëson dhe nënshkruan procesverbalet përkatëse dhe i dorëzon në Sekretarinë Mësimore të fakultetit. <i>Evidencë 10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit.pdf</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Nga shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit të dorëzuar nga UET, evidentohet se në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Kundrejt pagesës përkatëse dhe një kërkesë që duhet të depozitohet pranë Sekretarisë Mësimore, studenti mund të pajiset edhe me një kopje të programit të studimit. <i>Evidencë 15. Modeli i diplomës dhe Suplementi.pdf</i> <i>Evidencë 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf</i> <i>Evidencë 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Në sekretarinë mësimore ruhet i gjithë dokumentacioni për procesin mësimor të çdo viti akademik, që arkivohet sipas akteve ligjore në fuqi në zyrën e arkivë-protokollit. Në rastet kur kërkohet informacione për studentin, UET mund të vërë në dispozicion dokumentacionin që ka qenë në fuqi në periudhën kur ka qenë student pranë këtij institucioni. <i>Evidencë 9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore.pdf</i> <i>Evidencë 12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-8 të standardit III.5, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> - Përmbyllja e studimeve në programin e studimit MPTIAF realizohet nëpërmjet një projekti profesional me karakter aplikativ/praktik ose nëpërmjet një Provimi të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP). UET duhet të

	<i>marrë parasysh rekomandimet e Standardi II.1, kriteri 3.</i> - <i>Provimi final bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë gjithë viteve akademike duke përfshirë lëndë në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</i> - <i>Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</i> - <i>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</i> - <i>Studentët e programit të studimit MPTIAF kanë të gjithë asistencën e duhur për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</i> - <i>Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Nga konsultimi me dokumentet shoqëruese të RVB-së, konstatohet se DIT garanton mjedise jashtë institucionit të përshtatshme për realizimin e praktikës profesionale në kuadër edhe të marrëveshjes së bashkëpunimit me Bankën Credins për hapjen e këtij programi studimi. Gjithashtu, UET ofron ambiente laboratorike për realizimin e orëve laboratorike të parashikuara në programin mësimorë MPTIAF. <i>Evidencë 34.1. Marrëveshje bashkëpunimi UET dhe Credins në funksion të programit.pdf</i> <i>Evidencë 34. Marrëveshje bashkëpunimi - lista UET.pdf</i> <i>Evidencë 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit - Rr. “Xhanfize Keko”.pdf</i>

Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Nga vizita e zhvilluar në institucion rezultoi se studentët e MPTIAF kanë akses të plotë që të zhvillojnë orët mësimore me qasje praktike në laboratorët e institucionit të cilët janë të pajisur me PC, laptopë, printera, projektorë, kamera etj. me qëllim përfitimin më të mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. <i>Evidencë 42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit - Rr. "Xhanfize Keko".pdf</i>
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, si dhe nga takimet në institucion konstatohet se studenti është i detyruar të ndjekë praktikat profesionale të parashikuara në planin mësimor të programit MPTIAF. Praktikat profesionale ekuivalentohen në 12 kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës me notë. Mendimi i trajnerëve dhe vlerësimi përkatës i praktikës mbështeten mbi formularë të miratuar sipas Dokumentit B.I. Mbi Praktikën Profesionale (ndryshuar me vendim Senati Akademik Nr. 4, datë 14.02.2025). GVJ, në vazhdimësi të analizës së realizuar në standardin Standardin II.1, Kriteri 3, rekomandon hartimin e një paketë të detajuar të Praktikës profesionale specifikisht për programin e studimit MPTIAF, bazuar në dokumentet e përgjithshme Evidencaeruese institucionale dhe në përmbushje të të gjitha mangësive dhe parregullsive të evidentuara. <i>Evidencë 32.1.Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale.pdf</i>
Konkluzione	Bazuar në analizën e kriterëve 1-3 të standardit III.6, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se: - UET garanton mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale në kuadër edhe të marrëveshjes së bashkëpunimit me Bankën Credins për hapjen e këtij programi studimi. - Praktikat profesionale të zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																							
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Stafi akademik PAR dhe PAK i angazhuar në këtë program studimi, për 2 vitet e fundit akademike, është si më poshtë: <table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të PS</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr/Phd</td><td>3</td><td>-</td><td>5</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr. proc</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>1</td><td>3</td><td>1</td><td>2</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>5</td><td>4</td><td>7</td><td>4</td></tr></table>	Kualifikimi i stafit akademik të PS	2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	1	-	1	-	Prof. Asoc.	-	-	-	-	Dr/Phd	3	-	5	1	Dr. proc	-	1	-	1	Msc.	1	3	1	2	Gjithsej	5	4	7	4
Kualifikimi i stafit akademik të PS	2022-2023		2023-2024																																					
	PAE	PAK	PAE	PAK																																				
Prof. Dr	1	-	1	-																																				
Prof. Asoc.	-	-	-	-																																				
Dr/Phd	3	-	5	1																																				
Dr. proc	-	1	-	1																																				
Msc.	1	3	1	2																																				
Gjithsej	5	4	7	4																																				
	Ajo që është pozitive është që pedagogët e angazhuar vijnë nga një background i gjatë akademik/praktik që lidhet me fushat e																																							

	studimit që përfshin ky program. Studimi i CV të tyre, tregon që kanë merita kërkimore shkencore dhe ose profesionale. Stafit Msc vjen nga një përvojë e gjatë profesionale dhe angazhohet në lëndë specifike ku eksperiencia është një aset kryesor dhe zhvillimet kanë qënë të shpejta. <i>GVJ rekomandon që në programet e ardhshme ky staf me MSs, të orientohet drejt gradave shkencore.</i> <i>Evidenca 24. Tabelat 6.1, 6.2 ankes tabelat përmbledhëse</i>															
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga studimi i dokumentacionit dhe nga komunikimi me stafin e HR, vërejmë që ky kriter është plotësuar konform kërkesave ligjore për programin e studimit. Ngarkesa e orëve mësimore për stafin akademik PAE dhe PAK të angazhuar në këtë program studimi, për dy vitet e fundit akademike, është si më poshtë: <table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>2022-2023</td><td>744</td><td>496</td><td>248</td><td>67% / 33 %</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>988</td><td>716</td><td>272</td><td>72.5% / 27.5%</td></tr></table> Sipas ligjit për arsimin e lartë, ku thuhet që Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë të paktën 70% të ngarkesës së orëve mësimore, sipas tabelës 12.1, 12.2 në aneks tabelat përmbledhëse, vërehet që në vitin akademik 2022-2023, nuk plotësohet masa 70%, po ky raport është rregulluar në vitin pasardhës. <i>Evidenca 24. Tabelat 12.1, 12.2 aneks tabelat përmbledhëse</i> <i>Evidenca 11: Rregullore për burimet njerëzore</i>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2022-2023	744	496	248	67% / 33 %	2023-2024	988	716	272	72.5% / 27.5%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)												
2022-2023	744	496	248	67% / 33 %												
2023-2024	988	716	272	72.5% / 27.5%												
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë	Nga studimi i dokumentacionit dhe nga komunikimi me stafin e HR, vërejmë që ky kriter është plotësuar konform kërkesave ligjore për programin e studimit. Nga një kontroll me zgjedhje i disa dosjeve të stafit me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, janë respektuar kriteret ligjore në fuqi.															

kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	<i>Evidenca 11: Rregullore per burimet njerezore</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Pozitive për programin e studimit, është që stafi akademik i angazhuar, qoftë me kohë të pjesshme apo të plotë; ka formim akademik të përgjithshëm dhe specifik; dhe vjen nga një eksperiencë praktike që lidhet me atë cfarë synon të arrijë ky program studimi. Është avantazh që ofrohet një kombinim i tillë akademi/praktikë pasi në përfundim të studimeve; studenti ndihet i aftë të përballojë detyra në praktikë në vendin e punës. Edhe feedback-u i studentëve të diplomuar është shumë pozitiv; duke theksuar që në këtë program kishin përvetësuar njohuritë dhe teknikat e duhura për t'u përshtatur sa më mirë në punë. <i>Evidenca 11: Rregullore per burimet njerezore</i> <i>Evidenca 2: Statuti UET, Kreu 5, neni 4</i> <i>Evidenca 16: Kodi Etikes</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Infrastruktura e laboratoreve është e përshtatshme dhe funksionon brenda kapaciteteve. Sipas tabelave 1 dhe 2 te aneks tabelave permbledhese, nuk figuron që institucioni angazhon personel ndihmes akademik per oret laboratorike dhe mirembajtjen e laboratoreve. <i>Rekomandojmë që institucioni të parashikojë staf ndihmës akademik për të përmbushur orët laboratorike.</i> <i>Evidenca: Tabela 1. 2, Aneks tabelat</i> <i>Evidenca 42: Infrastruktura ne funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të	Ngarkesa mesimore është e dokumentuar dhe analitike për secilën Dosje nga stafi akademik që angazhohet në këtë program studimi si me kohë të plotë ashtu dhe me kohë të pjesshme, në përgjegjësi e Drejtuesit të Departamentit Informacioni i vënë në dispozicion është i përditësuar, me publikimet më të fundit, angazhimin në projekte të secilit staf akademik dhe të personit përgjegjës. <i>Evidenca 6: Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit</i> <i>Evidenca 11: Tabela 12, ngarkesa mesimore e stafit akademik</i> <i>Evidenca 32.1: Mbi praktiken profesionale pika B</i>

personelit ndihmës dhe administrativ.	
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Në pikat e forta të konstatuara në këtë program, është që stafi akademik ka: ✓ Eksperiencë profesionale në këtë fushë dhe njohuri të fundit mbi inovacionet ✓ një lidhje të fortë ndërveprimi me studentët e këtij programi per praktiken e diplome ✓ Komunikim të vazhdueshëm me institucionin ku zhvillohet praktika, Banka Credins Komunikimi lehtësohet nga LMS moodle dhe mjeteve të tjera elektronike. Numri i vogël i studentëve në vit akademik e bën të realizueshme dhe efektive këtë marrdhënie. <i>Evidenca 32.1: Mbi praktikën profesionale</i> <i>Evidenca 34.1: Memorandum bashkepunimi mes UET dhe Credins Bank</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Institucioni pritës është Banka Credins dhe praktika profesionale zhvillohet aty. Studentët kanë në dispozicion paisjet teknologjike dhe një mbikqyrës; i cili u përcakton detyra dhe jep përshkrimin e punës për secilin prej tyre në formën e një raporti përfundimtar. <i>Evidenca 32.1: Mbi praktikën profesionale</i> <i>Evidenca 34.1: Memorandum bashkepunimi mes UET dhe Credins Bank</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-8 të standardit IV.1 si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> ✓ Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi është i kualifikuar për natyrën e programit të studimit dhe i punësuar konform kuadrit ligjor ✓ është i qëndrueshëm ✓ Mbulon ngarkesën mësimore konform kornizës ligjore në fuqi ✓ Credins bank vë në dispozicion personelin dhe

	<i>infrastrukturën e nevojshme për praktikën</i> ✓ <i>Rekomandojmë që stafi me grada MSc të orientohej drejt gradave akademike në të ardhmen</i> ✓ <i>UET të evidentojë personel ndihmës akademik për organizimin e mirëmbajtjen e laboratorëve për programin specifik të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vizita në institucion vlerësojmë që sallat e leksionit ofrojnë ambjente dhe cilësi të përshtatshme për mësimin dhe kërkesat e programit specifik që po vlerësojmë. <i>Evidenca 42: Infrastruktura ne funksion të programeve te studimit</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga vizita në institucion vlerësojmë që sallat e leksionit ofrojnë ambjente dhe cilësi të përshtatshme për mësimin, janë të pajisura me bazën materiale e teknologjike të nevojshme, për të pasur një nxënie bashkëkohore. LMS Moodle shërben si platformë komunikimi e materialeve mësimore shtesë, ku studentët pajisen me materiale të azhornuara. Laboratorët ofrojnë kushte optimale për pjesën praktike në cilësi teknologjike dhe disponueshmëri. <i>Evidenca 42: Infrastruktura ne funksion të programeve te studimit</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike	Sic e përmendëm dhe në kriteret më lartë, laboratorët janë në kushte optimale dhe të aksesueshme, sallat e leksionit ofrojnë ambjente dhe cilësi të përshtatshme për mësimin dhe kërkesat e

të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	programit specifik që po vlerësojmë. LMS Moodle shërben si platformë komunikimi e materialeve mësimore shtesë, ku studentët pajisen me materiale të azhurnuara. Laboratorët ofrojnë kushte optimale për pjesën praktike në cilësi teknologjike dhe kapacitete. <i>Evidenca 42: Infrastruktura ne funksion të programeve te studimit</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Laboratorët janë në kushte optimale dhe të aksesueshme. Të gjithë kompjuterat kanë akses në internet, ku janë të lidhur me projector dhe pedagogu ka mundësi të shpjegojë dhe të demonstrojë gjatë leksioneve dhe ushtrimeve laboratorike. Platformat dhe programet që disponojnë bëjnë të mundur zhvillimin e orëve interaktive. <i>Evidenca 42: Infrastruktura ne funksion të programeve te studimit</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.	Bazuar në marrëveshjen me Bankën Credins, gjithashtu dhe nga intervistat me studentët, pjesa e praktikës zhvillohet në kushte optimale në lidhje me mjediset, vënien në dispozicion të teknologjisë, praktikës profesionale që nga job shadoëing dhe deri tek kryerja e detyrave të thjeshta në ambjentet e bankës.
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit IV.2 si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> ✓ UET zotëron infrastrukturën në kapacitetet dhe cilësinë e

	<i>duhur për zhvillimin e programeve mësimore, laboratorike dhe interaktive në kushte optimale.</i> ✓ <i>Kombinimi me praktikën e zhvilluar pranë Credins, siguron sinergji ndërmjet procesit të të nxënit dhe simulimit në auditor me kryerjen e detyrave praktike në situata reale pune.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë përmbush standardin e detyrueshëm që duhet të jetë e 5 viteve të fundit, ndërkohë literatura e sugjeruar vjen dhe në vitet të mëparshme në një pjesë të syllabus-eve. Literatura u vihet në dispozicion studentëve për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Nga intervistat me studentët, pedagogët nisin herë pas here dhe literaturë plotësuese sipas rastit, si artikuj shkencorë që cilësohen të rëndësishëm për lëndën. <i>Evidenca 45: Inventari i teksteve ne biblioteken per fushen e programit te studimit MPTIAF</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Nga dokumentacioni evidentohet një format kërkese për aplikimin për libra të rinj. Megjithatë rekomandojmë që në proceset e ardhme duhet të ketë një listë specifike për shtesat e librave të rinj në lidhje me programin, duke e evidentuar nga inventari i përgjithshëm i bibliotekës. <i>Evidenca 45.1: E-IV mbi funksionimin e bibliotekes</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e	Biblioteka mësimore është konform standarteve të kërkuara, ka sallë studimi, vend për konsultimin e librave dhe kopjutera nga ku mund të konsultojnë bibliotekat online ku UET është i abonuar. Sidomos dixhitalizimi e bën të mundur që aksesit i studentëve për të siguruar informacionin e dobishëm, të bëhet dhe në ambiente jo domosdoshmërisht të përcaktuara.

programit të studimit.	<i>Evidenca 42: Infrastruktura ne funksion të programeve te studimit</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e vënë në dispozicion nga UET siguron hapësirë të nevojshme për studentët për të konsultuar materialet fizike pa krijuar mbingarkesë. Fondi i librave në dispozicion për programin e studimit është i kënaqshëm dhe përfshin tituj të botuar në një periudhë të gjatë kohe. Studentët e programit pEvidencaerojnë bibliotekën digitale. <i>Evidenca 45.1: E-IV mbi funksionimin e bibliotekes</i> <i>Evidenca 42: Infrastruktura ne funksion të programeve te studimit</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	UET është i abonuar në disa biblioteka digitale: ● Ebsco ● Elgar Publishing ● Research4life etj Studentët e aksesojnë falas dhe në kushte të barabarta. <i>Evidenca 45.1: E-IV mbi funksionimin e bibliotekes</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Në ambjentet e bibliotekës ka kompjutera që mund të aksesohen bibliotekat digitale: ● Ebsco ● Elgar Publishing ● Research4life Studentët e aksesojnë falas dhe në kushte të barabarta. <i>Evidenca 42: Infrastruktura ne funksion të programeve te studimit</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave,	Biblioteka punon në oraret 8:00 me 20:00. ky orar është i përshtatshëm për studentët e programit që kemi në shqyrtim. Disponibiliteti i bibliotekave online dhe sistemit LMS moodle, mundëson që informacioni i kërkuar të sigurohet dhe shpërndahet shpejtë. <i>Evidenca 45.1: E-IV mbi funksionimin e bibliotekes</i>

numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.				
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Institucioni ka paraqitur dokumenta që paraqesin si rregullohen dhe organizohen këto procese në <i>evidencën 45.1</i> Biblioteka dhe njësia përgjegjëse e programit, raportojnë për cilësinë e fodnit fizik të bibliotekës dhe fondit online, përditësimin, sallat e leximit, përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe online. <i>Evidenca 45.1: E-IV mbi funksionimin e bibliotekes</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-8 të standardit IV.3 si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> ✓ UET ka një fond të pasur dhe të azhornuar literature për programin. ✓ Ofron akses në biblioteka online bashkëkohore. ✓ Ofron kapacitete të kënaqshme për studentët në terma të aksesit kompjuterik dhe sallës së leximit. ✓ Punon me orare të përshtatshme për programin e studimit. ✓ Azhornohehet në mënyrë periodike me tituj të fundit. ✓ Rekomandojmë të evidentohen shtesat e reja nga fondi ekzistues.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Menaxhimi i sekretarisë bëhet nëpërmjet sistemit UMS. Sistemi siguron databazën elektronike dhe regjistrimin e rezultateve për secilin student. Nga intervistat përdorimi i sistemit LMS moodle për menaxhimin e rezultateve nga pedagoget dhe studentët, shërben si sistem paralel auditues për UMS. Nga verifikimi i të dhënave me zgjedhje, nuk u vërejt parregullsi. <i>Evidenca 9: Mbi funksionimin e sekretarise mesimore</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Stafit i vihet në dispozicion një dosje me akses publik "Dokumenta të UET" nëpërmjet sistemit LMS moodle. Anëtarët e stafit gjatë intervistave u shprehën që ishin të njohur dhe kishin akses në të gjitha këto dokumenta; për nevoja të ndryshme të punës së tyre. <i>Evidenca 46: Manual i përdorimit të sistemit UMS</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Çdo staf i UET kanë akses në kohë reale në dosjen dokumenta UET dhe LMS Moodle. <i>Evidenca 46.2: UET LMS Guide per pedagogun</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	UET përdor LMS Moodle, MS Teams, UMIS, email personal ku sipas qëllimit shkëmbehet informacioni për të gjitha palët. Gjykojmë që këto platforma janë më se të mjaftueshme për të siguruar komunikim optimal. <i>Evidenca 46.3: UET LMS Guide per studentet</i> <i>Evidenca 46.2: UET LMS Guide per pedagogun</i> <i>Evidenca 47: www.uet.edu.al</i>
Kriteri 5. Sistemi i	Akresi në dokumentacionin e nevojshëm dhe gjindshmëria e

menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	platformave që ka universiteti sigurojnë që informacioni të aksesohet në kohë reale. Kjo jep mundësinë që dhe problematikat të adresohen në kohë reale. <i>Evidenca 46.3: UET LMS Guide per studentet</i> <i>Evidenca 46.2: UET LMS Guide per pedagogun</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Nga studimi i faqes së internetit ky kriter plotësohet, sipas kërkesave të standardit. Çdo informacion per programin, stafin akademik apo aktivitete jane te publikuara ne faqen e internetit. <i>Evidenca 47: www.uet.edu.al</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-6 të standardit IV.4 si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> ✓ <i>UET dispononon mjete bashkëkohore të komunikimit dhe manaxhimit të brendshëm të informacionit.</i> ✓ <i>Këto sisteme janë të përdorshme, të disponueshme lehtësisht dhe të besueshme e transparente nga stafi akademik, administrativ dhe studentet.</i> ✓ <i>UET azhuron në kohe reale faqen e internetit me informacione te dobishme dhe lajmerime te fundit</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe	Në dispozicion të ekspertëve të jashtëm janë vënë në dispozicion të gjitha dokumentat e nevojshme të situatës financiare dhe detajet e marrëveshjes me Bankën Credins. Marrëveshja për financim të pjesshëm dhe të plotë të studentëve, siguron që ky

planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	program të jetë i qëndrueshëm financiarisht. Gjithashtu institucioni buxheton shpenzimet për mbarëvajtjen e procesit mësimor, duke parashikuar mbulimin e shpenzimeve nga tarifat e studimit dhe të ardhura të tjera që vijnë nga grantet dhe projektet. <i>Evidenca 49: Te dhena mbi koston per student,, tabela 18.1</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Plani financiar i paraqitur, paraqet burimet e të ardhurave dhe shpenzimet e institucionit. Në tërësi UET ka financa të qëndrueshme për bibliotekën, librari digjitale dhe shpenzime operative, nisur dhe nga vlerësimi i auditimit ligjor. Burimet e financimit i kemi përmendur në kriterin e mësipërm. <i>Evidenca 50: Te ardhura dhe financime te ndryshme Tabela 18.2</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	UET është subjekt i auditimit të jashtëm, ku pasqyrat e tij certifikohen periodikisht nga një Auditues Ligjor. Nga raportet e auditimit, konkluzioni është që gjendja financiare raportohet me vërtetësi dhe ka besueshmëri. <i>Evidenca 2: Statuti UET</i> <i>Evidenca 50.2: Pasqyrat financiare 2022</i> <i>Evidenca 50.4: Raport Auditimi 2022,2023</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të	Plani financiar detajohet dhe komunikohet në fillim viti, ashtu sic parashikon dhe statuti deri në njësinë bazë përgjegjëse. <i>Evidenca 2: Statuti UET, Kreu 1, pika 10.7, neni 10</i>

miratuar të vitit paraardhës.				
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Institucioni kryen auditime të brendshme dhe analiza të kostos dhe drejtimit për të përcaktuar efektshmërinë financiare të programeve. UET është financiarisht i qëndrueshëm dhe eficient më menaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, nisur dhe nga studimi i pasqyrave financiare të cilat janë publike, së bashku me raportin e auditimit. <i>Evidenca 50.2: Pasqyrat financiare 2022</i> <i>Evidenca 50.4: Raport Auditimi 2022,2023</i> <i>Evidenca 49: Te dhena mbi koston per student,, tabela 18.1</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit IV.5 si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> <i>Gjykojmë që UET është financiarisht i shëndetshëm</i> <i>Ka mekanizma të fortë planifikimi dhe kontrolli financiar të brendshëm për të mbështetur misionin e tij. Publikon pasqyrat financiare Auditohet nga një Auditues Ligjor i pavarur</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura të mirëpërcaktuara që mbulojnë të gjithë ciklin akademik të studentëve, nga pranimi deri në diplomim, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të brendshme. Këto politika përfshijnë proceset e pranimi, orientimit, vlerësimit, përparimit akademik dhe përfundimit të studimeve. <i>Evidenca 2: Statuti UET</i> <i>Evidenca 5: Rregullore UET K3, neni 11</i> <i>Evidenca 27.1: Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimi te studenteve</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Procedurat garantojnë trajtim të barabartë dhe respektim të të drejtave për të gjithë kandidatët dhe studentët, pa dallim. Institucioni siguron transparencë dhe qartësi në çdo hap të ciklit akademik, përmes informimit të vazhdueshëm dhe mbështetjes administrative. Gjithashtu, rishikimi periodik i këtyre politikave siguron përshtatshmërinë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave akademike. <i>Evidenca 5: Rregullore UET Neni 11 dhe Neni 38 fq 4</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Për këtë program studimi, institucioni nuk parashikon kriteret ekstra dhe formati i aplikimit është i njëjtë me atë të çdo studenti që aplikon për studim në UET. <i>Evidenca 27.1: Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimi te studenteve</i> <i>Evidenca 47.1: Faqja zyrtare UET per aplikimin ne programin e studimit</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në rregulloren e UET përcaktohen qartë procedurat e pranimi të studentëve, transferimit të studentëve dhe transferimit të studimeve. Këto procedura, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga bisedimet në institucion janë të qarta dhe të kuptueshme. Institucioni ka në dispozicion struktura dhe dokumente të publikuara që lehtësojnë dhe qartësojnë këto procese. <i>Evidenca 47: www.uet.edu.al</i> <i>Evidenca 5: Rregullore UET Neni 11 dhe Neni 38, Neni 35</i>

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Gjykojmë që ky kriter plotësohet, nga studimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe shqyrtimi i burimeve të web dhe asistencë e dhënë në Zyrën e Këshillimit. Informacioni është shterues dhe siguron qartësi për kandidatët. <i>Evidenca 12: Mbi Funksionimin e Zyres se Keshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit</i> <i>Evidenca 27.2: Mbi tutoriatin dhe keshillimin akademik</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UET në faqen e internetit dhe Guidën që publikon paraqet informacion shterues për kandidatët me aftësi të veçanta dhe shtresat e marginalizuara dhe të pakicave, që duan të ndjekin studimet pranë tij. <i>Evidenca 47: www.uet.edu.al</i> <i>Evidenca 53: Ligji 80/2015 “ Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë” Neni 74</i> <i>Evidenca 27.1: Mbi politikat, kriteret dhe kerkimin shkencor ne IAL ne RSH</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Këto kriteret janë të përcaktuara qartë dhe konform akteve rregullatore në fuqi. Parashikohen kuota nga Trojet dhe ka rregulla të qarta për transferimet që vinë si nga IAL brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë. <i>Evidenca 28: Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UET ofron bursa të plota dhe të pjesshme për studentët sipas kriterëve që ajo publikon. Për programin në shqyrtim, Banka Credins rekruton nga studentët dhe në këtë rast financon 100% të tarifës së studimit. Ky është një model i zbatuar gjërësisht në universitete të mirënjohura të botës dhe në këtë rast e konsiderojmë si avantazh për këtë program studimi. <i>Evidenca 5: Rregullore UET Neni 12</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-8 të standardit V.1 si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> ✓ UET harton politika ne përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit të studimit. ✓ UET parashtron qartë kriteret e pranimi dhe aplikimit në programet e studimit, për të gjithë kandidatët në vend dhe nga jashtë territorit

	✓ Një praktikë e mirë për këtë program është lidhja e drejtpërdrejtë e studentëve të programit me tregun e punës dhe marrëveshje për financimin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Rregullorja e paraqitur për programin e studimit, shpjegon qartë të gjitha procedurat e parashtruara në këtë kriter: përparim akademik, vlerësimi, provimet etj Nga intervistat me studentët dhe me staf mbështetës të zyrës së këshillimit dhe karrierës ky proces funksionon në mënyrë optimale në praktikë. Studentët janë të qartë për të gjitha proceset e mësipërme. <i>Evidenca 5: Rregullore UET Neni 12</i> <i>Evidenca 7: Rregullore mesimore e MPTIAF fq 2</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Formalisht në këtë program këto procedura janë të përcaktuara qartë në dokumentin D.II "Mbi transferimet, njohjet e krediteve dhe mobilitetet". Praktikisht nuk ka pasur raste të tilla në këtë program. <i>Evidenca 5: Rregullore UET Neni 13</i> <i>Evidenca 28: Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin</i> <i>Evidenca 12: Mbi Funksionimin e Zyres se Keshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit</i> <i>Evidenca 27.2: Mbi tutoriatin dhe keshillimin akademik</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Kriteret janë të komunikuar, të qarta dhe të kuptueshme për pjesëmarrësit në këtë program dhe prezantohen në syllabusin e lëndëve përkatëse. <i>Evidenca 7: Rregullore mesimore e MPTIAF pika 5</i> <i>Evidenca 19: Syllabuset e ofruara ne MPTIAF</i>
Kriteri 4. Institucioni i	UET ka të formalizuar kriteret dhe procedurat e parashikuara

arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	nga kjo pjesë e standartit në dokumentin B.II. Nga komunikimet me studentët, ata ishin të qartë me aspektet e formatit, shkrimit, komunikimet dhe afatin e dorëzimit të temës. Kanalet e komunikimit të zhvilluara, lehtësojnë këtë proces. <i>Evidenca 10: Mbi punimin e diplomes dhe dizertacionit</i> <i>Evidenca 10.1: Kalendari akademik 2022-2023</i> <i>Evidenca 10.2: Kalendari akademik 2023-2024</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Informacioni i publikuar ne faqen e UET, Zyra e Këshillimit dhe Zyra e Karrierës, Ditët e hapura, rrjeti studentor sigurojnë një cilësi të mirë të informimit dhe komunikimit me studentët aktualë dhe potencialë. <i>Evidenca 51: Politika e marketingut te programit MPTIAF</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit V.2 si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> ✓ UET ka dokumentacion të publikuar, ✓ kanale informimi dhe ✓ struktura të ngritura <i>për të komunikuar kriteret, procedurat dhe aspekte të tjera të nxënies e vlerësimit për programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standartit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	UET i kushton rëndësi orientimit të studentëve në programin e studimit Master Profesional në “Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë”. Ky informacion aksesohet lehtësisht nga LMS Moodle, komunikimi me stafin akademik dhe struktura të tjera mbështetëse si Zyra e keshillimit dhe e karrieres

	<i>Evidenca 7: Rregullore mesimore e MPTIAF</i> <i>Evidenca 12: Mbi Funksionimin e Zyres se Keshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit</i> <i>Evidenca 5: Rregullore UET Neni 36,37</i> <i>Evidenca 46.3: UET LMS Guide per studentet</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Syllabuset, rregullorja dhe dokumente të tjera informative publikohen në LMS Moodle dhe faqen e universitetit. Studentët e vlerësojnë që orientohen lehtë dhe plotësisht në detajet që lidhen me përmbajtjen dhe formimin që ofron ky program. <i>Evidenca 46.3: UET LMS Guide per studentet</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Avantazhi kryesor i këtij programi, është mundësia për t'u rekrutuar në Bankën Credins në mënyrë të drejtpërdrejtë, por dhe banka të tjera të nivelit të dytë. Zhvillimet e reja teknologjike në sektorin bankar, ofrojnë mundësi të reja punësimi për studentë të këtij formimi. <i>Evidenca 12: Mbi Funksionimin e Zyres se Keshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	UET zoteron kapacitete, logjistike dhe infrastrukture të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të zhvilluar procesin mësimor. Studentet informohen nepermjet zyres se Keshillimit, kane drejtim nga departamenti, dhe kanale komunikimi ne platforma online për të adresuar nevoja për informacion në lidhje me procesin dhe ecurine e tyre ne programin mësimor e të vleresimit. <i>Evidenca 7: Rregullore mesimore e MPTIAF</i> <i>Evidenca 9: Mbi funksionimin e sekretarise mesimore</i> <i>Evidenca 27.2: Mbi tutoriatin dhe keshillimin akademik</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Siç e analizuam dhe në standardin paraardhës, UET ka të zhvilluara sisteme të fuqishme të komunikimit dhe të informacionit, LMS Moodle, MS Teams, UMIS, etj të cilat e bëjnë dhe lehtësisht të aksesueshëm pavarësisht vendndodhjes. <i>Evidenca 46.3: UET LMS Guide per studentet</i> <i>Evidenca 47: www.uet.edu.al</i>

Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kritereve 1-5 të standardit V.3 si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> <i>Prezantimi i programeve të formimit, njohurive dhe ndjekjes se ecurise është:</i> ✓ <i>i detajuar, lehtësisht i aksesueshëm,</i> ✓ <i>i azhornuar</i> ✓ <i>ekziston infrastruktura e logjistika përshtatshme</i> ✓ <i>dhe mbështetja e stafit akademik e mbështetës për t'i aksesuar lehtë dhe shpejtë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	Departamenti dhe sekretaria disponojnë dhe vënë në dispozicion statistikat e programit të studimit, në tabelën e evidencave të dorëzuara në dokumentacion. <i>Evidenca 27: Cilësia në hyrje dhe në dalje të MPTIAF</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	UET disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi. Numri i studentëve për dy vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-2024 është si më poshtë: Viti akademik 2022-2023 ka 7 studentë; Viti akademik 2023-2024 ka 6 studentë; Viti akademik 2024-2025 nuk ka patur regjistrime. <i>Evidenca 27: Cilësia në hyrje dhe në dalje të MPTIAF</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve	Sistemi UMIS administron të gjitha të dhënat statistikore të studentëve të programit të studimit, mirëmbahet në mënyrë të

duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	rregullt nga IT i Universitetit dhe nga verifikimi informacioni është i saktë. <i>Evidenca 9: Mbi funksionimin e sekretarise mesimore</i> <i>Evidenca 29: Monitorimi i ecurise se studenteve, diplomimi dhe punesimi i tyre MPTIAF</i>			
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mesimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Dosja e studentit administrohet në mënyrë automatike nga UMIS, kontrollohet periodikisht nga personat përgjegjës. Sekretaria disponon dhe back-up të ndryshme të këtyre informacioneve në funksion të sigurisë. <i>Evidenca 30.1 Plani i veprimit KSBC</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<i>Evidencaerenga nr 27</i> paraqet në mënyrë të detajuar notën mesatare në hyrje dhe në dalje të studentëve nga programi i studimit. Zyra e karrierës dhe Alumni kanë databazën e tyre në lidhje me punësimin e mëvonshëm dhe ecurinë e karrierës. Për vitin akademik 2022-2023 nota mesatare në hyrje është 7.86; Për vitin akademik 2023-2024 nota mesatare në hyrje është 6.34 <i>Evidenca 5: Rregullore UET kreu X neni 42</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit V.4 si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> <i>UET për programin e studimit në fjalë disponon mjetet dhe informacionin e nevojshëm për të administruar informacionin me studentët në programin e studimit nga fillimi e deri në përfundim të studimit; dhe cilësinë e ecurinë e tyre në tregun e punës. Të dhënat janë të ruajtura korrekt dhe kanë sisteme të shumëfishta kontrolli dhe back-up.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Studentët janë të përfaqësuar në një sërë organesh vendimmarrëse si: Këshilli studentor, Senati Akademik, Këshilli i Etikës etj. Nga intervistat me studentët, shprehen të kënaqur me përfaqësimin dhe influencën e tyre brenda këtyre organeve. Ata kanë mundësi reale të komunikojnë dhe ndikojnë në vendime të drejta dhe konstruktive. <i>Evidenca 5: Rregullore UET Neni 42 kreu X</i> <i>Evidenca 12: Mbi Funksionimin e Zyres së Keshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit</i> <i>Evidenca 47: www.uet.edu.al</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Si më sipër, ekzistojnë struktura funksionale të cilat sigurojnë përfaqësimin e studentëve brenda UET, ku adresohen problematika dhe jepen zgjidhje në funksion të mbarëvajtjes së programit të studimit. Komunikimi student pedagog vlerësohet si optimal nga vetë studentët. <i>Evidenca 7: Rregullore mesimore e MPTIAF pika 5.8</i> <i>Evidenca 5: Rregullore UET Neni 27, 28</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Studentët kanë akses të plotë në LMS Moodle dhe nëpërmjet pyetësorëve dhe formave të tjera direkte apo indirekte të komunikimit japin feedback e tyre formal për vështje të programit mësimor. <i>Evidenca 40: Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentet online</i> <i>Evidenca 6: Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit</i> <i>Evidenca 55.1: Kalendari aktivitetëve 2023-2024</i>
Kriteri 4. Studentëve u	Studentët kanë mundësi të shprehin opinionet e tyre qoftë direkt

mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	qoftë në mënyrë anonime për probleme që lindin në procesin mësimor. Transparenca që sigurohet nga sistemet e brendshme të komunikimit dhe përfaqësimi i tyre në struktura të ndryshme garanton ndershmërinë e vlerësimit të tyre dhe mundësitë e ankimimit. Studentët u shprehën të kënaqur nga intervistat e kryera. Evidenca 7: Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në "Teknologji Informatike dhe Aplikuar në Finance" Evidenca 5: Rregullore UET neni 27,28			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-4 të standardit V.5 si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në LAL konstatohet se:</i> ✓ <i>Studentët janë të përfaqësuar në struktura vendimmarrëse në UET.</i> ✓ <i>Studentët kanë akses real, të drejtë në informacionet mbi vlerësimet e tyre.</i> ✓ <i>Kanë mundësi për të shprehur opinionet dhe ankesat e tyre në lidhje me procesin mësimor dhe vlerësimin e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	UET organizon javën e Orientimit për studentët në lidhje me mënyrën e funksionimit brenda institucionit, orientimin për të drejtat dhe detyrimet dhe çështje të tjera që lidhen me to; përmbajtjen e programit mësimor dhe veprimtari të ndryshme. Zyra e Këshillimit luan një rol të rëndësishëm në sigurimin e informacionit të vazhdueshëm. <i>Evidenca 12: Mbi Funksionimin e Zyres së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit</i> <i>Evidenca 46.3: UET LMS Guide për studentet</i>
Kriteri 2. Institucioni ka	Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe nga vizitat, UET ka një

ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	strukturë të plotë dhe funksionale që garanton informimin; kanale virtuale dhe këshillimi individual si Zyra e Karrierës, koordinatori i departamentit, stafi akademik i departamentit, pedagogët e lëndës etj. <i>Evidenca 9: Mbi funksionimin e sekretarise mesimore</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Këshillimit dhe Zyra e Karrierës orientojnë studentët në lidhje me çështje të procesit mësimor, të praktikës mësimore në Bankën Credins dhe më pas në përgatitjen e tyre për tregun e punës. Që nga përgatitja e CV dhe asistimi i tyre në aplikime të ndryshme në subjekte private/shtetërore. <i>Evidenca 12: Mbi Funksionimin e Zyres se Keshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit</i> <i>Evidenca 27.2: Mbi tutoriatin dhe keshillimin akademik</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Rrjeti i Alumni është i gjerë, i zhvilluar dhe i azhurnuar. Të dhënat nga studentët e mëparshëm, zhvillimi i karierrës së tyre në tregun e punës siguron një databazë të mirë orientuese si për stafin akademik dhe për studentët e ardhëm për të orientuar zgjedhjet e tyre në kuadër të përmirësimit të cilësisë së studimit, dhe perspektivës së punës. <i>Evidenca 12: Mbi Funksionimin e Zyres se Keshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-4 të standardit V.6 si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> ✓ <i>UET ofron mbështetje të mjaftueshme dhe të dobishme për orientimin e studentëve dhe gjatë procesit të formimit të</i>

	tyre, dhe në përgatitjen për tregun e punës. ✓ Lidhja me rrjetin Alumni, e bën afër zhvillimeve të reja të tregut, duke orientuar siç duhet dhe studentët e ardhshëm dhe ata aktualë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Nisur nga cv dhe nga intervistat me personelin akademik, institucioni mbështet stafin akademik të përditësohet me metodat më të fundit të mësimdhënies. Bashkëpunimet në praktikë, programet e shkëmbimit dhe angazhimi insitucional në diseminimin e tyre. <i>Evidenca 33: Strategjia e kerkimit shkencor UET 2021-2025</i> <i>Evidenca 30.9: Metodologjia e punes KSBC_Silabuset</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Institucioni ka ngritur një protokoll vlerësimi për vlerësimin dhe nevojave për përditësim të metodave të mësimdhënies në stafin akademik në tërësi dhe për programin në veçanti. Ky mekanizëm gjykohet eficient dhe përfshin : 1. Vlerësimin e mësimdhënies në auditor 2. Vlerësimin nga studentët 3. Angazhimi dhe raportet e KSBC Një pjesë e pedagogëve, për vetë natyrën e programit shprehën nevojën për të qenë të angazhuar në praktikë part time, për të qenë në të njëjtën linjë; kërkesë të cilën e vlerësojmë si pozitive në sigurimin e cilësisë së programit të ofruar.

	<i>Evidenca 5: Rregullore UET</i> <i>Evidenca 30.13: Metodologjia e punes KSBC_Fokus Grupi</i> <i>Evidenca 30.9: Metodologjia e punes KSBC_Sylabuset</i> <i>Evidenca 30.5: Metodologjia e punes KSBC_Provimet</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Nga dokumentacioni i paraqitur dhe nga intervistat e studentëve dhe stafit, UET ka në zbatim një strukturë eficiente për trajtimin dhe adresimin në kohë të ankesave dhe të vlerësimeve. <i>Evidenca 5: Rregullore UET</i> <i>Evidenca 41: Format vetevlerësimi per personelin akademik</i> <i>Evidenca 40: Format vlerësimi nga pedagoget online</i> <i>Evidenca 40.2: Format per ankesat e studenteve</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Trajtimi i vlerësimeve të mësimdhënies nga KSBC, bëhen publike për stafin akademik dhe KSBC harton raporte që evidentojnë problematikat e veçanta. Kjo praktike institucionale siguron që të adresohen në kohë problematika në lidhje me procesin mësimor. Ajo që ne vlerësojmë, është dhe procesi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve për përmirësim nga Departamenti përkatës. <i>Evidenca 2: Statuti UET</i> <i>Evidenca 40: Format vlerësimi nga pedagoget online</i> <i>Evidenca 8: Dokument mbi vlerësimin e brendshëm te cilesise</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Gjykuar nga takimet dhe intervistat me Drejtuesin e departamentit dhe stafin akademik; rezulton që diskutimi i praktikave më të mira ndodh në mënyrë të vazhdueshme në programin që kemi në shqyrtim. Është pozitive që për fushën e studimit, shpejtësinë me të cilën inovacioni ndodh në praktikë, dhe ndërveprimin mes palëve, ky proces ndodh në mënyrë spontane dhe jo vetëm në mënyrë të skeduar. <i>Evidenca 5: Rregullore UET, Kreu V</i>
Konkluzione	Bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit VI.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se: -sigurimi i cilësisë në mësimdhënie është një proces që zhvillohet dhe ndiqet me seriozitet nga Institucioni për programin në shqyrtim. - Pozitive është bashkëpunimi mes palëve që marrja e njohurive dhe praktika të jenë sa më afër njëra tjetrës.

	- Insitucioni ka mekanizma kontrolli per sigurimin e cilesise dhe adresimin e problematikave ne kohe.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UET, si universitet me eksperiencë të gjatë i arsimit të lartë dhe numrit të lartë të programeve të studimit ka në vend struktura dhe procedura, të cilat janë konform me kërkesat ligjore në fuqi. <i>Evidenca 53: Ligji 80/2015 per arsimin e larte dhe Kerkimin shkencor ne IAL</i> <i>Evidenca. 53.2: VKM nr. 824 dt 24.12.2021</i> <i>Evidenca 3: Plani Strategjik 2024-2025, Prioritetet II</i> <i>Evidenca 30.3.1: Vendim Senati Nr. 15: Per miratimin e strategjise se Sigurimit te Cilesise 2023-2028</i> <i>Evidenca 30.2: Manuali per sigurimin e brendshem te cilesise.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	1. UET ka ngritur një strukturë të posaçme për sigurimin e cilësisë pranë institucionit (KSBC). Kjo strukturë ka kompetenca dhe përgjegjësi dhe kopentenca të përcaktuara qartë. Nga intervistat me përfaqësues; gjykojmë që kjo strukturë funksionon me një strategji të qartë dhe ka zhvilluar procedura të qarta ndër vite për adresimin e problematikave në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. 2. Studentët janë të përfaqësuar nëpërmjet fokus grupeve; dhe shprehen të kënaqur me aksesin që kanë për të dhënë input (pyetësorë, takime etj). 3. UET angazhon ekspertë të jashtëm në përmirësimin e cilësisë. Programi i studimit është produkt i iniciuar nga Banka Credins, dhe si insitucion privat ka komunikim për përmirësimin e vazhdueshëm. <i>Evidenca 2: Statuti UET, Neni 1</i> <i>Evidenca 5: Rregullore UET</i>

	<i>Evidenca 30.3: Strategjia per sig e brendshem te Cilesise 2023-2028</i>			
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	UET, nisur nga jetëgjatësia e tij si institucion i Arsimit të Lartë, ka kaluar disa procese akreditimi dhe vlerësimi të jashtëm. Vazhdimësia e tij është një indikator që ka përgjegjësinë e duhur në ngritjen e proceseve, monitorimit të tyre dhe reflektimit për përmirësim të vazhdueshëm. <i>Evidenca 54.3: VBA Nr 12, dt 7/4/2017 "Per akreditimin institucional te UET"</i>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	KSBC, ka zhvilluar një proces të konsoliduar tashmë, në nivel institucional me instrumenta të testuar (pyetësorë, takime, fokus grupe etj). produkti kryesor është raporti i cili rekomandon detyra për çështjet dhe informimi i strukturave drejtuese. Ky raport përpilohet dhe për programin e studimit që është objekt i akreditimit dhe nga evidencat e intervistat ka komunikim të ndërsjellë ndërmjet strukturave. <i>Evidenca 30.9: Metodologjia KSBC Silabuset</i> <i>Evidenca 30.10: Matrica e perputhshmerise Silabuset</i> <i>Evidenca 37: Relacion DIT Monitorimi i silabuseve sem 1 2021-2022</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-4 të standardit VI.2 si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> ✓ <i>UET ka instaluar struktura të cilat hartojnë procedura dhe dokumenta te posaçme për vlerësimin e brendshëm të cilësisë.</i> ✓ <i>KSBC, Zyra e Standardeve etj kontrollon për përputhshmëri syllabuset e lëndëve dhe hartojnë mekanizma për input në kohë dhe transparent nga stafi e studentët.</i> ✓ <i>Rezultatet komunikohen në raporte dhe komunikime, të cilat janë të aksesueshme dhe transparente.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe komunikimet gjatë intervistimit; UET ka ndërtuar një praktikë institucionale mbi raportimin dhe komunikimin e çështjeve të lidhura me cilësinë. Programi që po vlerësojmë është pjesë e këtyre raportimeve në nivel njësie bazë dhe institucionesh drejtuese. Stafi akademik dhe KSBC kanë paraqitur dokumentacion të mjaftueshëm për ta argumentuar plotësimin e këtij standardi. <i>Evidenca 30.6: Metodologjia KSBC Provimet</i> <i>Evidenca 30.7: Komunikime shperndarja e raportit te KSBC mbi provimet</i> <i>Evidenca 30.8: Raporte kontrolli per tezat e provimeve</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe	Dokumentacioni i vënë në dispozicion si template dhe si produkt përfundimtar, tregon një praktikë të konsoliduar nga universiteti dhe programi në veçanti për mbajtjen dhe sigurimin e cilësisë. Në vijim të vlerësimit të diskutuar më lart, komunikimi ndërmjet paleve mbi problematikat dhe rezultatet, ndjekja e procesit nga strukturat dhe KSBC, është funksionale dhe e dokumentuar dhe në produkte që i janë vënë në dispozicion ekspertëve të jashtëm. <i>Evidenca 30.6: Metodologjia KSBC Provimet</i> <i>Evidenca 30.7: Komunikime shperndarja e raportit te KSBC mbi provimet</i> <i>Evidenca 30.8: Raporte kontrolli per tezat e provimeve</i> <i>Evidenca. 8: Dokumenti mbi sigurimin e brendshem te cilesise.</i>

studentët. Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Instrumentat që UET përdor në përgjithësi dhe në veçanti për matjen dhe cilësinë e programi në diskutim janë: ✓ Të matshme - sigurojnë një metrikë të qartë për programet ✓ Të vazhdueshme - japin mundësi të shikohet rezultati cilësor në kohë ✓ Specifike - ndërtohen në raport me tregues të vecantë për programin Gjykojmë që këto instrumenta përdoren vazhdimisht në kuadër të sigurimit të vazhdueshëm të cilësisë. Gjithashtu marreveshjet e shumta që ka universiteti në këto fushe sigurojnë mundësi të larmishme të zhvillimit të praktikës. <i>Evidenca. 38: Analiza e departamentit përgjegjës për arritjen e objektivave formuese</i> <i>Evidenca 27: Cilesia në hyrje e dalje</i> <i>Evidenca 30.1 Plani i veprimit KSBC</i> <i>Evidenca 34: Marreveshje bashkepunimi UET</i> <i>Evidenca 29: Monitorimi i ecurisë së studentëve dhe punësimit të tyre</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	Një aspekt shumë pozitiv është mbajtja e database dhe e lidhjeve të vazhdueshme me të diplomuarit (Alumni) në UET. Nga intervistat e zhvilluara me një grup të diplomuarish, feedback i marrë është pozitiv, duke e cilësuar edukimin e marrë në këtë program si të dobishëm, konform kërkesave të tregut të punës. Një pjesë e tyre e kishin sugjeruar dhe e sugjeronin fort. Nga studentët aktualë, një pjesë kishin mësuar dhe ishin sugjeruar nga të diplomuarit e vitit paraardhës. Personeli akademik, ndihet i motivuar për të zhvilluar metoda të reja dhe për të qënë sa më i azhornuar, pasi ky program është i ndërtuar si rezultat i kërkesave specifike që tregu i punës sot. <i>Evidenca 30.3: Strategjia për sigurimin e cilësisë 2023-2028</i>

Konkluzione	Bazuar në analizën e kriterëve 1-4 të standardit VI.3 si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se: ✓ UET monitoron dhe raporton në mënyrë periodike ecurinë e programit të studimit, qoftë nëpërmjet proceseve të brendshme dhe atyre të jashtme. ✓ Evidenton dhe adreson problematikat në kohë. ✓ Ka një strategji afatgjate për sigurimin e cilësisë që shërben dhe si orientim drejt standardeve të përcaktuara nga aktet ligjore në fuqi dhe ato të përcaktuara nga UET. ✓ Ka rrjet të gjerë për sigurimin e praktikës/punësimit të studimit. ✓ Ka të konsoliduar rrjetin e Alumnit për kontakte dhe analiza të vazhdueshme cilësore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në zbatim të këtij kriteri gjykojmë që dokumentacioni i paraqitur, praktikën me të cilët u njohëm më në detaje gjatë intervistave tregojnë qartë që aparati i ndërtuar sidomos nga KSBC është funksional dhe garanton ndjekjen dhe sigurimin të cilësisë në vazhdueshmëri. <i>Evidenca 30.3: Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028</i> <i>Evidenca 30.2: Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të	Raportet e paraqitura dhe detajimi në takimet tregojnë që trajtimi i problematikave nuk bëhet vetëm në vija të përgjithshme por trajtohen dhe problematika specifike që lindin gjatë procesit të mësimdhënies. Një shembull i mirë, ishte komunikimi i ndërtuar mes pedagogëve të lëndës dhe grupit të studentëve për raste studimore.

studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	<i>Evidenca 30.2: Manuali per sigurimin e brendshem të cilësisë, S2, pika 4.3</i> <i>Evidenca 30.3: Strategjia per sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028</i> <i>Evidenca 19: Silabuset e lendeve te ofruara ne MPTIAF</i> <i>Evidenca 14.2: Plani mesimor i programit shqip</i> <i>Evidenca 14.4: Plani mesimor i ndare sipas veprimtarive formuese</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Gjykojmë që komunikimi mes strukturave është i mjaftueshëm, mes drejtuesit të departamentit, stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm dhe studentëve. Sic e kemi evidentuar dhe më sipër, një ndër aspektet më pozitive është që kanalet e komunikimit janë shumë të zhvilluara mes palëve ku adresohen pyetje, kërkesa dhe çështje të tjera që dalin gjatë procesit mësimor. <i>Evidenca 2: Statuti UET, Neni 11 pika 11.2</i> <i>Evidenca 30.1: Plani i veprimit KSBC</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Nisur dhe nga komunikimet që patëm me stafin akademik dhe studentët; të gjithë palët kanë mundësinë të jenë të përfaqësuar në proceset ciklike në mënyrë etike dhe të barabartë. Një garanci të tillë e ofron dhe fakti që shumë procese, si pyetësore etj, menaxhohen nëpërmjet programit LMS moodle. Vlerësojmë si pozitive, iniciativën që ka ndërmarrë institucioni që të zhvillojë një program specifik për administrimin e komunikimit dhe procesit mësimor; duke shtuar dhe përmirësuar opsione që LMS moodle mund të mos i ketë në dispozicion. <i>Evidenca 16: Kodi i Etikes, pika A.II/2-4/4.1</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të	Stafi akademik me kohë të pjesshme, sic e kemi përmendur dhe në pjesë të tjera të vlerësimit janë të angazhuar si profesionistë të lirë ose pranë institucioneve të tregut privat. Kjo lidhje praktike/akademi është vlerë e shtuar, sidomos për programin pasi praktika dhe dija duhet të ecin në të njëjtin drejtim. Është eksperiencia e sjellë sidomos e këtij grupi që siguron që njohuria që merret në shkollë të jetë e përditësuar me atë cfarë tregu i punës pret nga këta studentë. Pjesëmarrja ne Panairin e Punes cdo vit, ofron feedback te rendesishem per kerkesen e

vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	tregut për punë. <i>Evidenca 12.3.1: Panairi i punës poster</i> <i>Evidenca 32: Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkepunuese për programin e studimit dhe praktikën profesionale</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit VI.4 si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> ✓ UET është shumë i angazhuar në sigurimin e matjes dhe të ruajtjes së cilësisë në programin e shqyrtuar. ✓ Si vlerë të shtuar përmendim faktin që ka fokus në matjen sasiore të cilësisë së programit të studimit dhe një komunikim mes aktorëve dhe palëve të interesuar në këtë drejtim. ✓ UET është pjesë e një rrjeti të gjerë bashkëpunimesh që ofron eksperiencë praktike dhe mundësi punësimi për studentët e tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Universiteti ka një strukturë për sigurimin e cilësisë, e cila nga intervistat shpjegoi misionin e saj, mënyrën si operon për të siguruar që programi përmbush qëllimin e tij me studentët. Këto janë të rregulluara në dokumentat e UET dhe të publikuara në faqen zyrtare të tij. Ka komunikim zyrtar me departamentet në formë shkresore dhe me studentët, nëpërmjet platformave digitale që ka UET. <u>uet.edu.al/raporte vleresimi</u> <i>Evidenca 16: Kodi i ETikes pika A.II</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën	Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit, njihet me rezultatet e pyetësoreve pasi ato përpunohen individualisht. Cdo vlerësim i jashtëm u vihet në dispozicion stafit akademik. <i>Evidenca 16: Kodi i ETikes pika A.II</i>

akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.				
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Komunikimi i vazhdueshëm dhe transparent, përfaqësimi i studentëve në struktura pranë departamentit dhe në shkallë Universiteti, garanton transparencë dhe seriozitet në ndërtimin e strategjive për adresimin e mangësive, duke dale me nje plan konkret masash per t'u ndjekur.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Syllabuset e lëndëve azhurnohen në mënyrë periodike dhe stafi akademik, në veprimtarinë e tij të përditshme kujdeset që cilësia e njohurive e transmetimit të tyre, të jetë e kohës dhe në mënyrën më të mirë të mundshme. <i>Evidenca 43: Te dhena mbi kerkimin shkencor te DIT ne UET</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Takimet në Asamblenë e Pedagogëve dhe trajnimet e vazhdueshme, diskutimet në mbledhjet e departamentit sigurojnë në terren të përshtatshëm për të adresuar sigurimin dhe rritjen e vazhdueshme të cilësisë së programit të studimit. <i>Evidenca 33: Lista e trajnimeve profesionale</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit VI.5 si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> ✓ <i>Përgjegjësit për programin e studimit dhe strukturat përkatëse, i kushtojnë rëndësi të vazhdueshme sigurimit të cilësisë së programit të studimit në shqyrtim.</i> ✓ <i>Hartohen plane dhe masa konkrete për sigurimin e cilësisë së brendshme në lidhje me materialet mësimore të programit të studimit.</i> ✓ <i>Komunikimet janë transparente dhe lehtësisht të aksesueshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbyshjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbyshet	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Teknologji Informacioni e Aplikuar në Financë” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. DIT zotëron kapacitetet e duhura akademike për ofrimin e këtij programi studimi.
2. Institucioni ofron një nivel të kënaqshëm qëndrueshmërie në personelin akademik të anagazhuar në MPTIAF.
3. Bashkëpunimi dhe klima pozitive e krijuar mes dekanit, përgjegjësit të departamentit, stafit akademik si edhe studentëve mbështet plotësisht përmirësimin e cilësisë së programit.
4. Personeli akademik është pjesë e aktiviteteve kërkimore shkencore si dhe pedagogët e DIT dhe më gjerë inkurajohen nga universiteti me anë të granteve dhe shpërblimeve për publikime shkencore dhe avancimin e titujve akademike.
5. Personeli akademik i programit të studimit MPTIAF në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukton studentët me qëllim realizimin e kompetencave të tyre formuese.
6. Institucioni ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione publike dhe kompani private në vend dhe jashtë në funksion të realizimit të programit të studimit, në mënyrë të vëçantë me Bankën Credins.
7. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.
8. Institucioni garanton mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale në kuadër edhe të marrëveshjes së bashkëpunimit me Bankën Credins për hapjen e këtij programi studimi.
9. Ekzistojnë struktura të qarta për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe procedura të dokumentuara për rekrutimin dhe angazhimin e stafit akademik.
10. Aksesimi në biblioteka online dhe menaxhimi i sistemeve të brendshme të komunikimit, bën që studenti dhe stafi akademik të aksesojë informacion akademik dhe administrativ në kohë reale.

11. LMS moodle dhe format e tjera të komunikimit të ngritura garantojnë komunikime të vazhdueshme për procesin e mësimdhënies, vlerësimit dhe problematika që mund të lindin gjatë procesit.
12. Strukturat e brendshme të komunikimit dhe të përfaqësimit të studentëve, sigurojnë transparencë, impakt në sigurimin e cilësisë dhe adresimin e problemeve në kohë reale.
13. Afërsia në tregun e punës nëpërmjet rrjetit Alumni, siguron një instrument të fuqishëm në orientimin e stafit mësimor dhe studentëve aktualë dhe të ardhëm.
14. UET është financiarisht I qëndrueshëm dhe ka planifikim të shëndetshëm të financave të tij
15. Kujdeset për menaxhimin e brendshëm të cilësisë në porgramin e studimit

Pika të dobëta

1. Mungon një paketë e detajuar e Praktikës profesionale specifikisht për programin e studimit MPTIAF si dhe syllabusi i lëndës “Praktikë/internship” nuk përfshin temat që parashikohen të zhvillohen në institucionin e praktikës, Bankën Credins. *(Standardi II.1, Kriteri 3 & Standardi II.2, Kriteri 1)*
2. Ka mospërputhje ndërmjet syllabuseve të lëndëve dhe planit mësimor të miratuar të MPTIAF. *(Standardi II.3, Kriteri 4)*

Rekomandime

1. Rekomandohet hartimi i një paketë të detajuar të Praktikës profesionale specifikisht për programin e studimit MPTIAF, bazuar në dokumentet e përgjithshme Evidencaeruese institucionale dhe në përmbushje të të gjitha mangësive dhe parregullsive të evidentuara në *Standardin II.1, Kriteri 3 dhe Standardin II.2, Kriteri 1*.
2. Rekomandohet përcaktimi i pragut të notës mesatare për të mbrojtur një Punim Diplome edhe në Rregulloren e programit të studimit MPTIAF dhe unifikim të dokumentacionit lidhur me masën e frekuentimit të Seancave Metodologjike. *(Standardi II.1, Kriteri 3)*
3. Rekomandohet që lëndët që bëjnë pjesë në një grup-lëndësh me zgjedhje të kenë të njëjtën ngarkesë mësimore në auditor. *(Standardi II.2, Kriteri 1)*
4. Rekomandohet që UET/DIT ta shpërndajë dhe ta Evidencalektojë në orarin mësimorë të gjithë ngarkesën në auditor për Punim Diplome, ose ta kalojë ngarkesën e pashpërndarë si punë e pavarur e studentit. *(Standardi II.2, Kriteri 1)*
5. Rekomandohet të shtohet tipologjia e lëndës, të rakordohet mospërputhja e ngarkesës dhe/ose veprimtarive mësimore që Evidencalektohen në syllabus-e me atë që është miratuar në planin mësimor, të azhurnohet masa e duhur e frekuentimit të detyrueshëm të procesit mësimor (75% ose 80%) dhe të Evidencalektohet në syllabus ngarkesa e

shprehur në kolonën e planit mësimor “Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor”. (Standardi II.3, Kriteri 4)

6. Rekomandohet që DIT të punojë për rritjen e përfshirjen e studentëve në aktivitete kërkimore dhe mobilitete në kuadër të bashkëpunimeve në projekte Erasmus+ që lidhen ngushtë me fushën e këtij programi studimi. (Standardi II.6, Kriteri 3 & Standardi II.4, Kriteri 4)
7. Rekomandohet që stafi me gradë Msc të orientohe në grada shkencore (për ata të cilët nuk janë regjistruar akoma) (Standardi IV.1. Kriteri 1)
8. Rekomandohet që UET të evidentojë personelin ndihmës akademik për orët laboratorike të programit të studimit. (Standardi 4.3, Kriteri 1)
9. Rekomandohet që të evidentohet për efekt raportimi pasurimi I fundit I bibliotekës fizike me tituj të rinj për fushën e studimit. (Standardi 4.3, Kriteri 8)
10. Rekomandohet përfshirje dhe angazhim i studentëve në aktivitete kërkimore dhe mobilitete në kuadër të bashkëpunimeve në projekte Erasmus+ që lidhen ngushtë me fushën e këtij programi studimi.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master “Information Technology Applied to Finance” provided by the Higher Education Institution “European University of Tirana”

Strengths and affirmations

1. DIT has the academic capacity to deliver this programme.
2. The institution provides satisfactory sustainability levels for the academic staff engaged in MPTIAF.
3. The positive working relationship between the dean, department head, academic staff and students is a key factor in improving the quality of the programme.
4. Academic staff participate in scientific research activities, and lecturers of DIT and beyond are encouraged by the university to advance their academic titles and publish scientific papers through grants and awards.
5. The academic staff involved in the MPTIAF study programme provide continuous support, guidance and instruction to students to help them develop their formative competencies.
6. The institution has established cooperative relations with public institutions and private companies in the country and abroad in order to fulfil the requirements of the study programme, particularly with Credins Bank.
7. The programme trains professionals to be competitive in the national and international labour market.



8. The institution guarantees suitable environments, both within and outside the institution, for the realisation of laboratory and professional practice, as part of the cooperation agreement with Credins Bank for the opening of this study programme.
9. Clear structures are in place for human resources management, and documented procedures support the recruitment and engagement of academic staff.
10. Access to online libraries and management of internal communication systems, allows students and academic staff to access academic and administrative information in real time.
11. LMS moodle and other established communication formats guarantee continuous communication about the teaching process, assessment and issues that may arise during the process.
12. Internal communication and student representation structures ensure transparency, impact on quality assurance and addressing problems in real time.
13. Proximity to the labor market through the Alumni network, provides a powerful instrument in the orientation of teaching staff and current and future students.
14. UET is financially stable and has sound financial planning
15. Takes care of internal quality management in the study program

Weaknesses

1. *Standard II.1, Criterion 3 and Standard II.2, Criterion 1* - There is no detailed package of professional practice specifically for the MPTIAF study programme, and the syllabus for the 'Practice/Internship' course does not include topics expected to be developed at the practice institution (Credins Bank).
2. *Standard II.3, Criterion 4* - There are inconsistencies between the course syllabuses and the approved MPTIAF curriculum.

Recommendation

1. It is recommended that a detailed Professional Practice package be drafted specifically for the MPTIAF study program, based on the general institutional Evidenceaerence documents and in compliance with all deficiencies and irregularities identified in *Standard II.1, Criterion 3 and Standard II.2, Criterion 1*.
2. It is recommended that the average grade required to defend a Diploma Thesis in the MPTIAF study programme is defined, and the documentation regarding the attendance rate of Methodological Sessions is unified. (*Standard II.1, Criterion 3*).
3. Subjects that are part of an elective course group should have the same teaching load in the classroom (*Standard II.2, Criterion 1*).
4. It is recommended that UET/DIT distribute and Evidencealect in the teaching schedule the entire load in the classroom for the Diploma Thesis, or pass the undistributed load as independent work of the student. (*Standard II.2, Criterion 1*)

5. It is recommended to add the typology of the subject to reconcile the inconsistency of the workload and/or learning activities evidenced in the syllabus with what has been approved in the curriculum, to update the appropriate measure of mandatory attendance of the learning process (75% or 80%) and to evidence in the syllabus the workload expressed in the curriculum column "Forms of continuous control and professional practice sessions, developed in the auditorium". (*Standard II.3, Criterion 4*).
6. It is recommended that DIT work to increase student involvement in research activities and mobility within the framework of Erasmus+ projects. These should be closely related to the field of the study programme. (*Standards II.6, Criterion 3 and II.4, Criterion 4*).
7. It is recommended that staff with MSc degrees be oriented towards scientific degrees (for those who have not yet registered) (*Standard IV.1.Criterion 1*)
8. It is recommended that UET record the academic support staff for the laboratory hours of the study program. (*Standard 4.3, Criterion 1*)
9. It is recommended that the latest enrichment of the physical library with new titles for the field of study be recorded for reporting purposes. (*Standard 4.3, Criterion 8*)
10. It is recommended students are not sufficiently involved in or committed to research activities or mobility within the framework of Erasmus+ collaborations closely related to this study programme.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X